

**BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM**

## **TASAVVUFI PËR FILLESTARË**

**Siraceddin Önlüer**

**Prishtinë, 2015**

SHTËPIA BOTUESE **“PIRAMIDA”** PRISHTINË

**Për botuesin:**

Mustafë Voca, ecc. i dipl.

Titulli i origjinalit

**Rahmet Kapısı**

**Përgatiti dhe përktheu**

Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

**Përgatitja kompjuterike:**

İlhan Bölükbaşı

U shtyp në shtypshkronjën SHKROLA PRINT

**ISBN**

## Përmbajtja

|                                                   |                                     |
|---------------------------------------------------|-------------------------------------|
| <b>IMANI-BESIMI.....</b>                          | <b>Error! Bookmark not defined.</b> |
| DIN - FEJA .....                                  | 7                                   |
| ISLAMI.....                                       | 7                                   |
| IMANI.....                                        | 8                                   |
| IHSANI.....                                       | 8                                   |
| VLERAT E LARTA TË IMANIT .....                    | 9                                   |
| IMANI, DHURATA MË E MADHE PËR NJERIUN.....        | 11                                  |
| KUFRI- MOSBESIMI.....                             | 12                                  |
| KUFRI NË LIDHJE ME ALLAHUN TEALA .....            | 12                                  |
| KUFRI NË LIDHJE ME KUR’ANIN.....                  | 13                                  |
| KUFRI NË LIDHJE ME RESULALLAHUN S.A.V.S. ....     | 13                                  |
| KUFRI NË LIDHJE ME URDHRAT E FESË.....            | 14                                  |
| SHIRKU.....                                       | 15                                  |
| LIDHJET MES KUFRIT DHE SHIRKUT.....               | 15                                  |
| DYFYTYRËSIA DHE MYNAFIKU .....                    | 16                                  |
| KUPTIMI THEMELOR I EHL-I SUNNETIT .....           | 16                                  |
| <br>                                              |                                     |
| <b>DITURIA DHE PUNA .....</b>                     | <b>21</b>                           |
| RËNDËSIA E DITURISË .....                         | 21                                  |
| VLERA E LARTË E DITURISË .....                    | 24                                  |
| TË MËSUARIT ËSHTË FARZ.....                       | 25                                  |
| LIDHJET MES DITURISË DHE PRAKTIKIMIT TË SAJ ..... | 27                                  |

|                                             |           |
|---------------------------------------------|-----------|
| NJERIU DHE VEPRAT .....                     | 28        |
| AMELI SALIH (PUNËT E MIRA) .....            | 31        |
| LIDHJET MES AMELIT DHE NIJETIT .....        | 32        |
| <b>ILMIHAL.....</b>                         | <b>35</b> |
| TAHARETI - PASTËRTIA .....                  | 35        |
| RËNDËSIA E PASTËRTISË NË ISLAM .....        | 36        |
| PASTËRTIA E ZEMRËS .....                    | 37        |
| RREGULLAT KUR SHKOJMË NË TUALET .....       | 39        |
| ISTINXHA DHE ISTIBRA.....                   | 40        |
| ABDESI .....                                | 41        |
| FARZET E ABDESIT .....                      | 44        |
| SUNNETET E ABDESIT .....                    | 45        |
| MUSTEHABET (TË PREFERUARAT) E ABDESIT ..... | 46        |
| GJËRAT QË E PRISHIN ABDESIN .....           | 47        |
| PUNËT QË NUK MUND TË KRYHEN PA ABDES .....  | 47        |
| GUSULI (LARJA E TËRË TRUPIT) .....          | 48        |
| KUR DUHET TË MERRET GUSULI .....            | 48        |
| FARZET E GUSULIT .....                      | 49        |
| SUNNETET E GUSULIT .....                    | 49        |
| GJËRAT E NDALUARA KUR JEMI PA GUSUL .....   | 50        |
| TEJEMMUMI .....                             | 51        |

|                                           |           |
|-------------------------------------------|-----------|
| <b>NAMAZI DHE RËNDËSIA E TIJ .....</b>    | <b>52</b> |
| KUSHTET DHE RUKNET E NAMAZIT .....        | 55        |
| KUSHTET DHE FARZET E NAMAZIT .....        | 55        |
| LLOJET E NAMAZIT.....                     | 57        |
| KOHA E NAMAZEVE FARZ.....                 | 60        |
| <br><b>TASAVVUFI DHE QËLLIMI.....</b>     | <b>63</b> |
| KUSH ËSHTË SUFI? .....                    | 64        |
| HAPI I PARË NË TASAVVUF .....             | 65        |
| EDUKATA DHE TASAVVUFI .....               | 67        |
| MORALI DHE RËNDËSIA E TIJ.....            | 68        |
| MORALI I SUFIUT .....                     | 72        |
| SI DUHET TË JETË NJË DITË E SUFIUT? ..... | 75        |
| RËNDËSIA E EDUKATËS.....                  | 83        |
| EDUKATA NDAJ ALLAHUT TEALA.....           | 84        |
| PIKAT KRYESORE TË EDUKATËS SË SUFIUT..... | 84        |
| KUR SUFIU RRI ME NJERËZ... ..             | 86        |
| EDUKATA NDAJ PEJGAMBERIT S.A.V.S. ....    | 88        |
| EDUKATA NDAJ MURSHIDIT.....               | 90        |
| IRSHAD DHE MURSHID .....                  | 92        |
| TË VEÇANTAT E MURSHIDIT .....             | 92        |
| LIDHJA ME MURSHIDIN .....                 | 93        |
| BISEDA FETARE - SOHBET .....              | 95        |

|                                              |     |
|----------------------------------------------|-----|
| QËLLIMI I SOHBETIT .....                     | 95  |
| MUHABBETI .....                              | 101 |
| SINQERITETI NË MUHABBET .....                | 102 |
| SI DUHET TA DUASH MURSHIDIN .....            | 103 |
| IHLAS.....                                   | 105 |
| MURIDI DHE IHLASI .....                      | 106 |
| UNË KAM VETËM NJË ZEMËR.....                 | 107 |
| MURSHIDI KËRKON SINQERITET .....             | 108 |
| DORËZIMI .....                               | 109 |
| RABITA .....                                 | 112 |
| URDHRI I FESË.....                           | 113 |
| NJË VEÇORI QË I PËRKET NJERIUT .....         | 114 |
| DHIKRI .....                                 | 115 |
| FLAMURI I VELAJETIT (EVLIJALLËKUT).....      | 119 |
| LEJA DHE NDJEKJA E MURSHIDIT NË DHIKËR ..... | 120 |
| MËSIMI I HAKIKATIT NGA KOMPETENTI.....       | 120 |
| ÇKA DO TË THOTË VIRD? .....                  | 123 |
| VAZHDIMËSIA E DHIKRIT ËSHTË KUSHT .....      | 123 |
| VLERAT E LARTA TË HATM-I HAXHEGAN.....       | 125 |
| VLERA E LARTË E HIZMETIT .....               | 129 |
| EDUKATA NË HIZMET .....                      | 131 |
| RREZIKU MË I MADH NË HIZMET .....            | 132 |

## IMANI-BESIMI

### DIN - FEJA

Feja përfshinë ligjet hyjnore të përcaktuara nga Allahu Teala. Këto ligje i bëjnë me dije krijesës njeri qëllimin e krijimit dhe ekzistencës së tij në këtë botë. Feja mëson njeriun se si duhet bërë adhurim Allahut Teala, i bën thirrje njeriut në vepra të mira dhe largim nga veprat e këqija.

Resulallahu Sal-lallahu alejhi ve sel-lem na mëson se feja fillon me besim (Iman), përforcohet me adhurim (ibadet), dhe përsoset me singëritet (ihsan).

### ISLAMI

Me fjalën islam nënkuptojmë dorëzimin e plotë ndaj Allahut Teala. Me fjalë të tjera: bindjen që t'i përshtatesh urdhreve të Allahut Teala, të dërguarit të Tij - Muhammedit s.a.v.s., dhe asaj çfarë i është shpallur Muhammedit s.a.v.s.. Islam është (1) dëshmia që nuk ka ilah tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi s.a.v.s. është i Dërguari i Allahut Teala, (2) falja e namazit, (3) dhënia e zekatit, (4) agjërimi i Ramazanit dhe (5) shkuarja në Haxh (për ata që kanë mundësi).

## IMANI

Iman është të besuarit Allahut Teala, Melaiket e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e Ahiretit, dhe Kaderin (caktimin nga ana e Tij të së mirës dhe së keqes).

Iman është besimi me zemër dhe shqiptimi me gojë, i gjithë asaj çfarë i është shpallur Muhammedit s.a.v.s.. Andaj, robi i Allahut është i obliguar që të besojë, atë që e beson ta shqiptojë me gojën e tij – respektivisht, ta praktikojë. Besimtari i cili kryen këto obligime quhet mysliman dhe besimtar i vërtetë (mumin).

## IHSANI

Ihsan është të bërit ibadet (adhurim) Allahun Teala sikur ta shihnim Allahun; edhe pse ne nuk e shohim, Ai neve na sheh.

Siç shihet, feja është e ndërtuar nga tri shtylla kryesore: islam, iman dhe ihsan. Imani është shtylla kryesore e fesë. Me këtë lëmi merren dijetarët e kelamit, ndërkaq me jurisprudencën islame, respektivisht me fushën e ibadeteve merren dijetarët e Fikh-ut, që në terminologjinë islame njihen si fakihë. Kurse ihsani përfitohet duke i ndjekur udhëzimet e evliave (miqve) të Allahut Teala - murshidëve kamil.

## VLERAT E LARTA TË IMANIT

Imani është drita (nur) të cilën Allahu Teala e vuri në zemrën e robit të Tij, është një mëshirë (rahmet) e veçantë, është hidajet (udhëzim). Imani është jeta shpirtërore, e cila e vë në funksion jetën materiale të krijesës njeri.

Imani është elementi kyç i myslimanit, gjegjësisht bazë e fesë islame. Imani është hapi i parë i myslimanit në rrugën e Allahut Teala. Krijesa njeri ka nevojë për besim (iman) që nga mosha madhore, përderisa është në jetë, atëherë kur të vdesë, gjatë jetës në varr (periudhës mes dy botëve) dhe në Ditën e Gjykimit (Mahsher). Njeriu, fillimisht pyetet për iman. Imani është çelësi i xhennetit, dhe ai që nuk e posedon këtë çelës nuk mund të hyj në xhennet.

Gjëja më me vlerë të cilën Allahu Teala ia dhuroi krijesës njeri është mbjellja e dritës së imanit në zemrën e tij. Kjo është mirësi dhe vlerë të cilën Allahu Teala ia jep krijesës së Tij më të dashur - njeriut. Mbijellja e imanit në zemrat e robërve është dëshirë e Allahut Teala. Nëse Allahu nuk dëshiron ta udhëzojë dikë me iman, sikur e gjithë bota dhe çfarë ka brenda saj të angazhoheshin për një gjë të tillë, nuk do të mund ta bënin.

Në lidhje me këtë në Kur'an thuhet:

**“Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për ta pranuar islamin. Atë që dëshiron ta lë të humbur, zemrën e tij ia bën të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu Allahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë.”** 6-En'am: 125.

Edhe Pejgamberi s.a.v.s. dëshironte shumë që xhaxhai i tij të jetë nga besimtarët, që të paktën një herë, ai të shqiptojë dëshminë (Kelime-i Shehadetin).

Në lidhje me këtë i zbriti edhe ajeti Kur'anor:

**“Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë, dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit.”**

28-Kasas: 56.

Andaj imani është dhurata më e madhe nga Allahu Teala për krijesën njeri. Të gjithë Pejgamberët kanë bërë thirrje te njerëzit në besimin e drejtë - njëshmërinë e Allahut Teala, për të arritur këtë nimet që aludon në iman. Kjo, për shkak se imani i jep kuptim jetës.

## IMANI, DHURATA MË E MADHE PËR NJERIUN

Transmetohet se një ditë, derisa Pejgamberi s.a.v.s. ishte ulur me shokët e tij te xhamia, brenda në xhami Bilali Habeshiu, nga gëzimi që ndjente, filloi të vallëzonte dhe të bënte lëvizje të pakontrollueshme. Hazreti Omeri r.a., hyri në xhami dhe e pyeti:

*“O Bilal, çfarë po ndodh me ty, ke harruar se je në xhaminë e Pejgamberit s.a.v.s.?”*

Bilali Habeshiu iu drejtua Hazreti Omerit r.a.:

*“Çfarë paska me mua? Nëse do, shko dhe tregoja gjendjen time Resulallahut s.a.v.s. e nëse ai thotë që e kam gabim, do të pendohem sinqerisht dhe nuk do ta përsëris më kurrë.”*

Kjo përgjigje e habitit Hz. Omerin; ai shkoi te Resulallahu s.a.v.s. dhe i tregoi.

I Dërguari i Allahut, Muhammedi s.a.v.s. e thirri Bilalin dhe e pyeti:

*“O Bilal, çfarë është me ty që je kaq i lumtur?”*

Bilali r.a. iu drejtua:

*“O i Dërguari i Allahut, a nuk isha unë një skllav, e Allahu më udhëzoi në islam, përderisa shumë nga të parët e Mekës nuk e shijuan dot këtë dhuratë (imanin). Nëse unë nuk meritoj të gëzohem për këtë dhunti nga ana e Allahut Teala., atëherë kush meriton të gëzohet?”*

Resulallahu s.a.v.s., tha:

**“Bilali ka të drejtë, lëreni të qetë, le të gëzohet e le të festojë ashtu si dëshiron ai.”**

## KUFRI- MOSBESIMI

Fjala kufër, gjuhësisht ka kuptimin: mbulim, fshehje, qëndrim larg dhe mohim i bamirësisë, që nënkupton se është e kundërta e imanit. Ndërsa, në terminologjinë islame ka kuptimin: mosbesim në Allahun Teala, Melaiket, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij, në Ditën e Ahiretit dhe Kaderin.

## KUFRI NË LIDHJE ME ALLAHUN TEALA

Cilësimi i Allahut Teala me veti të cilat nuk i takojnë Atij, p.sh. ngjasimi i Allahut me krijesat e Tij, me gjëra apo me diçka tjetër; kufizimi i Allahut për një kohë dhe një vend; të përshkruarit fëmijë, lindje apo vdekje Allahut Teala.; të besuarit se Ai është materie dhe gjëra të ngjashme, të besuara, deklaruar ose pretenduara, të tilla që na qojnë në mosbesim.

## KUFRI NË LIDHJE ME KUR'ANIN

Kufër konsiderohet edhe mungesa e respektit ndaj ajeteve (citateve) Kur'anore, sharja e tyre, refuzimi i ndonjërit nga këto ajete, ndryshimi i ndonjërit prej tyre, dyshimi në ajete, nënçmimi i tyre dhe të ngjashme.

## KUFRI NË LIDHJE ME RESULALLAHUN S.A.V.S.

Kufër konsiderohet edhe mohimi i Muhammedit s.a.v.s. si i dërguar i Allahut Teala, përmendja e tij me emra që bien ndesh me terminologjinë e edukatës islame, nënçmimi dhe mallkimi (i Pejgamberit a.s.), refuzimi i ndonjërit nga sunnetet (porositë) e Pejgamberit s.a.v.s., p.sh. besimi se “rritja e mjekrës është papastërti” ose përqeshja e një mjekre që i është përshtatur sunnetit; mohimi i muxhizeve të Pejgamberit s.a.v.s, trashëgimtarëve të tij – evliave, duke mohuar kerametet e tyre; për Hadith-et e Pejgamberit s.a.v.s. të mendohet ose thuhet *“unë kam dëgjuar shumë fjalë kësi soji”* ose *“robi nuk përfiton asgjë prej sunnet-it, është i kotë”* ose *“po të ishte filani Pejgamber, atij do t’i besoj”* dhe të ngjashme.

## KUFRI NË LIDHJE ME URDHRAT E FESË

Kufër është edhe mosbesimi i asaj që është dëshmuar me Kur'an dhe me hadith-et e Pejgamberit s.a.v.s., mosbesimi i urdhrave të njohur për faljen e namazit, dhënien e zekatit, agjërimin e Ramazanit dhe udhëtimin në Haxh si urdhra të prerë të ardhur nga Allahu Teala përmes Pejgamberit të tij s.a.v.s.; mosbesimi në gjërat e lejuara (hallal) dhe ato të ndaluara (haram); të gjykuarit në ligjet e prera të Allahut Teala p.sh.: *“Do të ishte më mirë sikur Ramazani të mos ishte obligim (farz),”* ose *“Sikur Allahu të mos e obligonte një gjë të tillë unë s'do ta bëja”*.

Gjithashtu, të quhet një mysliman qafir është kufër, si edhe besimi në magji e në fall, humbja e shpresës nga mëshira e Allahut Teala, sharja e as'habëve (shokëve të Pejgamberit s.a.v.s.), besimi se evliatë janë më lartë se Pejgamberët, dhe besimi në atë se evliaja pas një periudhe të caktuar nuk ka nevojë të falë namaz dhe të bëjë ibadet.

Kufër është edhe të pohuarit me gojë: *“ti që fale namaz, çfarë ndryshove në jetë për të mirë...”*, *“Allahu e ka harruar këtë njeri...”*, *“pa ty nuk shkoj as në xhennet...”* dhe fjalë tjera të ngjashme.

## SHIRKU

Me *shirk* nënkuptojmë besimin në Allahun Teala, por duke i bashkangjitur ortak të barabartë Atij. Kjo nënkupton përshkrimin e cilësive që i takojnë vetëm Allahut Teala (siç është krijimi) edhe tjetër kujt. Pra, besimi edhe në fuqi tjera përveç Allahut Teala – përngjasimin e Allahut me ndonjë krijesë tjetër. Është shirk t'i bëhet ibadet tjetër kujt përveç Allahut Teala. Ata që i bëjnë shirk Allahut quhen mushrik.

## LIDHJET MES KUFRIT DHE SHIRKUT

Dallimi mes fjalës 'shirk' dhe 'kufër' është shumë i madh, për faktin se me shprehjen kufër nënkuptohen të gjithë ata të cilët e mohojnë Allahun Teala ndërsa me shirk nënkuptohet besimi në më shumë se një Allah - d.m.th. të bërit ortak Allahut Teala.

Me fjalë të tjera, shirku përfshinë të gjitha besimet e kota.

Shirku është njëri nga llojet e kufrit.

Çdo mushrik është qafir (jobesimtar), por, çdo qafir nuk është mushrik, për shkak se kufri paraqitet me mohim të njëres nga esencat e imanit, e në shirk mund të ndodh që nuk ka mohim.

## DYFYTYRËSIA DHE MYNAFIKU

Dyfytyrësi është qëndrimi a sjellja me dy fytyra, hipokrizi, fshehja e fytyrës së vërtetë. Njerëzit që kanë këto cilësi quhen mynafik (hipokrit, dyfytyrësh).

Mynafiku, edhe pse nuk beson me zemër Allahun, paraqitet kinse është mysliman, për përfitime personale.

### KUPTIMI THEMELOR I EHL-I SUNNETIT

Besimi i Ehl-i sunnetit është kushti themelor në adhurim dhe në miqësi me Allahun Teala. Shpëtimi është në besimin e Ehli-i sunnetit.

Burimi i fesë është shpallja (vahj). Burimi i shpalljes është Allahu Teala.

Kur’ani Kerim është fjala e Allahut Teala dhe është nën mbrojtjen hyjnore.

Ehl-i sunneti nuk e pranon asnjë besim dhe ibadet që nuk ka mbështetje në Kur’an dhe sunnet.

As’habët janë larg prej dështimit në çështje të fesë, ata janë me fjalë të drejtë, me vepra të drejta, me vlera të larta, të ndershëm. Të gjithë as’habët i duam me respekt dhe i përmendim me nder. E pranojmë se në mesin e tyre ekziston dallim në grada dhe në vlera të larta. Prej as’habëve më të lartësuar janë Hz. Ebu Bekri r.a., Hz. Omeri r.a., Hz. Osmani r.a., dhe Hz. Aliu r.a., Halifet e vërtetë janë gjithashtu në këtë rradhitje.

Në punët e fesë, as'habët janë një dëshmi dhe burim për ne. Fjalët e tyre në lidhje me fenë dhe me zbatimet, përbëjnë shembull për ne. Vetëm se, kur As'habët kanë mendime të ndryshme për të njëjtën çështje, në këso rastesh neve na jepet mundësia e zgjedhjes.

Dashuria ndaj Muhammedit s.a.v.s., familjes së tij (Ehl-i bejt), të pastrit dhe sojit të ndershëm, është nevojë e imanit dhe shenjë e dashurisë ndaj Muhammedit s.a.v.s.

Të gjithë myslimanët që janë në jetë, dhe ata që kanë vdekur, janë vëllezërit tanë. Për ata lutemi që të shpërblehen për veprat e mira dhe bëjmë istigfar për mangësitë e tyre.

Ne nuk e gjykojmë asnjë besimtar (mumin) duke thënë *“ai bëri gjynah të madh, gaboi, tha një mendim ndryshë”*. Nuk mund t'i themi një myslimani *“ti dole nga feja”* pa e pasur një dëshmi veprë ose fjale të tij, që e qet atë prej fesë.

Ka dallim mes myslimanëve në sinqeritet (ihlas), veprim (ibadet) dhe devotshmëri (takva). Më i vlefshëm tek Allahu Teala është ai i cili është më i devotshëm në vepra.

Të gjithë besimtarët (muminët) janë miq të Allahut Teala. Ata që janë muttaki (të devotshëm) dhe që janë në kulmin e devotshmërisë, për dallim prej besimtarëve (muminëve) të tjerë, kanë fituar miqësi të

veçantë ndaj Allahut Teala. Këta besimtarë të singertë në Kur'an janë të njohur me emra dhe veti si: "*muhsin*", "*mukarrabun*", "*ebrar*", "*muttaki*", "*rixhalullah*", "*evlijaullah*".

Ata që posedojnë këto cilësi, do të gjenden në këtë ummet në çdo periudhë deri në kijamet; ata i udhëzojnë njerëzit në rrugën e Allahut, në kohërat kur feja është në shuarje ata e rringjallin kuptimin e saj, e gjallërojnë ibadetin dhe adhurimin. Këtyre njerëzve u thuhet *muxheddid* dhe *murshid*.

Kerametet që shihen tek miqtë e Allahut janë të vërteta, mirëpo ky nuk është kusht për evliatë dhe ata nuk kanë nevojë për to. Kerameti më i bukur është të ecet ditë e natë me dashurinë e Allahut Teala në rrugën e drejtë.

Pasuesi i Ehl-i sunnetit çdo gjë që e bën, e bën për Allahun Teala. Ai person, kë e do - e do për hir të Allahut, dhe kë e urren - e urren për hir të Allahut Teala. Njeriu i drejtë nuk i bëhet askujt armik për qejfin apo për nefsin (unin) e vet. Në të njëjtën kohë ai nuk bie në fanatizëm të xhemateve dhe medh'hebeve që të shkaktojë ndarje mes myslimanëve, nuk frikohet nga kritikata, përfiton nga mendimet e ndryshme - sepse rruga e tij është Kur'ani dhe Sunneti i Muhammedit s.a.v.s..

Myslimani, për asnjë moment nuk i bën keq dikujt. Për çdo çështje gjykon me drejtësi. Pika bazë e myslimanit është vetë sjellja e tij e moralshme në mënyrë që të bëhet shembull për të tjerët. Myslimani gjatë gjithë kohës është i moralshëm, i sjellshëm, falës dhe këshillues ndaj të tjerëve.

Debatet ndërmjet medh'hebeve tek myslimanët nuk shërbejnë për t'i përçarë ata, përkundrazi - shumësia e mendimeve është pasuri (mirësi) e islamit. Andaj në fenë islame edhe kemi shkolla (medh'heb) të ndryshme të cilat karakterizohen me shumësinë e mendimeve dhe që të gjitha këto medh'hebe kanë bazën në islam. Të gjitha medh'hebet janë paraqitur për t'i shërbyer fesë, përbrenda esencës së saj. Të gjithë janë pjesë e një tërësie sikurse gishtat e një dore apo degët e një peme.

Ndërmjetësimi (shefat) në Ahiret i Muhammedit s.a.v.s., i atyre që kanë zbatuar urdhrat e fesë me dinjitet, si dhe i evliave, me lejen e Allahut Teala, është hak (i vërtetë). Në Ahiret, muminët do të shohin bukurinë e Allahut Teala. Xheneti dhe Xhehenemi janë të përjetshëm. Të gjithë ata që kanë besim dhe dashuri në zemër edhe sa grimca ndaj Allahut Teala, edhe nëse hyjnë në Xhehenem, nuk do të qëndrojnë në të përjetësisht.



## DITURIA DHE PUNA

### RËNDËSIA E DITURISË

Dituri është përpjekja për të kuptuar se çka është një gjë e caktuar. Vlerë më të lartë se dituria nuk ka, e të mësosh për vete dhe të mësosh të tjerët është ibadeti më i madh i mundshëm. Kjo sepse dituria është mjet për t'u afruar dhe për të njohur Hakun. Njëkohësisht, Alim (dijetar) është njëri prej emrave të bukur të Allahut - dituria është njëra nga cilësitë e Tij.

Dituria vjen para veprimit. Një dituri mësohet, e pastaj bëhet vepra që i përshtatet kësaj diturie. Për këtë arsye dituria renditet para veprimit. E imani (besimi) është në pikën fillestare. Imani, ka përparësi edhe ndaj diturisë. Pejgamberët, së pari kanë ftuar njerëzit në iman, e më pas kanë ftuar në dituri dhe në të praktikuarit e asaj që kanë mësuar.

## Besimi i Sufive

*“Të mëdhenjtë e kësaj rruge themelin e veprimeve të tyre e kanë ndërtuar mbi besimin (akide) e sigurt.*

*Duke i ikur besimeve që nuk përputhen me Kur’an dhe sunnet, ata ruajtën besimin nga çdo lloj risije (bidat).*

*Duke iu përshtatur rrugës së të mëdhenjve të parë (selef) dhe Ehl-i sunnetit, ata posedojnë një besim e tehvid që nuk i përshkruan ngjashmëri Allahut Teala me krijesa, dhe që nuk mohon cilësitë hyjnore.*

*Duke besuar në ekzistencën që nuk ka fillim (Kadim), kanë njohur Qenien e Allahut në mënyrë të merituar; dhe duke ditur se ata vetë janë krijuar prej asgjëje, ata u përulën dhe u dorëzuan karshi Allahut Teala.”*

Kushejri Risala

## Para së gjithash dituria...

Të mëdhenjtë kanë arritur deri te gradat e veta me dituri. Për këtë arsye, diturisë i është dhënë aq shumë rëndësi. Shejh Muhammed Dijauddin i njohur me emrin Hazret, së bashku me shokët dhe nxënësit e tij, kishte luftuar në Luftën e Parë Botërore kundër Rusëve. Hazreti kishte humbur edhe krahun e djathtë, i qëlluar nga një predhë. Një ngjarje tregohet në lidhje me këtë luftë:

Për shkak të strategjisë së luftës, duhej që çetat ushtarake të ndërronin pozicion dhe të kalonin në një vend tjetër. Pasi që arritën në vend të caktuar, bashkë me nxënësit, ata ngritën çadrën e kuzhinës. Pas pak Hazreti kaloi pranë çadrës dhe nuk dëgjoi zëra të leximit.... Ai pyeti:

*“Nuk po dëgjoj zërin e nxënësve. Kjo çadër, për çka është?”*

*“Kjo çadër është ngritur për ta përgatitur ushqimin”, iu përgjigjën ata.*

Atëherë Hazreti iu drejtua nxënësve:

*“Nëse është kështu, atëherë ne nuk kemi se për çfarë të luftojmë, përderisa dihet se lufta me armikun bëhet për ta mbrojtur fjalën e Allahut dhe kjo fitore mund të arrihet duke dhënë arsim nëpër medrese (shkolla). Andaj, ju urdhëroj që menjëherë ta ngrehni çadrën e medreses e më pas atë të ushqimit”.*

Dhe, me t’u ndërtuar çadra e medreses, Hazreti vazhdoi luftën me armikun.

## VLERA E LARTË E DITURISË

Të mësuarit në fenë tonë zë një vend shumë të rëndësishëm për faktin se feja Islame është e ndërtuar mbi diturinë. Andaj edhe ajetet e para të Kur'anit Kerim kanë të bëjnë me diturinë dhe na porositin për të. Allahu Teala në Kur'anin e madhëruar thotë:

**“Lexo me emrin e Rabbit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Rabbi yt është Bujari më i madh, I Cili, me anë të penës, la mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”**

96-Alak: 1-5.

## TË MËSUARIT ËSHTË FARZ

Ashtu siç është farz të adhurohet Allahu me ibadete që janë të përcaktuara nga Ai, gjithashtu edhe të mësuarit se si kryhen këto ibadete, është farz. Andaj edhe Pejgamberi s.a.v.s. thotë:

**“Të mësuarit është farz për çdo mysliman dhe myslimane”<sup>1</sup>**

Njeriu, para së gjithash duhet ta njohë besimin islam, ashtu siç është zbritur, pa të meta; duhet ta dijë dhe besojë Kur’anin dhe Hadithet e Pejgamberit s.a.v.s.. Njeriu është i obliguar që t’i praktikojë urdhrat e Allahut Teala dhe sunnetin e Pejgamberit s.a.v.s., duhet pasur njohuri mbi gjërat e lejuara dhe të ndaluara apo haramet dhe hallallet.

Myslimani duhet të dijë se si falet namazi dhe cilat janë farzet, njëkohësisht kushtet dhe gjërat të cilat e prishin atë.

Gjithashtu edhe agjëruesi duhet të ketë njohuri për Ramazanin, duke përfshirë farzet, sunnetet dhe gjërat të cilat e prishin atë. Myslimani duhet të ketë

---

<sup>1</sup> Ibn Maxhe, 224; Mukaddime, Bejhaki, Shuaby`l-Iman, nr, 1663; Taberani, es-Sagir, nr.22

njohuri për zeqatin, kush obligohet me zeqatë, kujt dhe si duhet t'i jepet ai. Gjithsesi duhet të kemi njohuri edhe për Haxhin, rregullat e tij, etj. Edhe myslimani tregtar duhet të ketë njohuri për tregtinë e lejuar dhe të ndaluar në islam.

Shejh Sejjid Muhammed Rashid nxënësve të tij, iu drejtohej me këto fjalë:

*“Çdo i pa-ditur është në humbje, edhe nëse është sufi ose abid<sup>2</sup>.*

*O robërit e Allahut! Mësimi i një nxënësi (talebe) është më e vlefshme se sa njëmijë vetë të bëhen murid<sup>3</sup> (sufi), e sidomos nëse nxënësi bëhet trashëgimtar i Pejgamberit s.a.v.s.. Ju mësoni fenë në vendin tuaj, prej dijetarëve të devotshëm. Mos pyetni çdo kënd për të marrë fetva. Ai që ia kushton jetën e tij diturisë, është duke bërë punën më të vlefshme në këtë dynja. Aty ku nuk ka dituri, ka injorancë. Në rrugën e Nakshibendisë, medreseja dhe teqeja janë të pandashme”.*

---

<sup>2</sup> **Abid:** *ai që bën shumë ibadet.*

<sup>3</sup> Murid: vullnet; dëshirë; ai që ka hyrë në tarikat; nxënësi i shehut / murshidit; murid i thuhet personit i cili me dashuri dhe vetëdëshirë zgjedh një shejh (murshidi kamil), hyn në rrugë të drejtë dhe kërkon kënaqësinë (rizanë) e Allahut Teala; murid i vërtetë është ai i cili me singëritet i është dorëzuar shejhut.

## LIDHJET MES DITURISË DHE PRAKTIKIMIT TË SAJ

Dituria dhe të praktikuarit e saj janë një tërësi e cila nuk mund të ndahet dot. Nëse njëra mungon, tjetra e humb kuptimin. Dituria bëhet e vlefshme vetëm atëherë kur ajo praktikohet në vepër.

Por kur praktika bëhet me singëritet (ihlas) ajo bëhet edhe më e vlefshme. Ndërsa ihlasi është të bërit e një vepre vetëm për kënaqësinë (riza) e Allahut.

Ihlasi bëhet shkak që Allahu Teala t'i dhurojë njeriut zgjuarsi dhe mirësi. Falënderim (shukr) për dituri, është veprimi. Ndërsa falënderim për veprimin, është dituria.

Qëllimi i të mësuarit dituri është për ta njohur të vërtetën, për nënshtrim dhe adhurim të plotë ndaj Allahut Teala, dhe për të mësuar edukatën e ibadetit.

Imami Gazali thotë:

*“Janë dy gjëra për të cilat të gjithë dijetarët dhe mësuesit kanë shkruar shumë libra. Të gjithë librat hyjnorë kanë zbritur për të na dhënë njohuri mbi to, të*

*gjithë Pejgamberët e Allahut Teala kanë bërë thirrje për to. Aq më shumë, edhe kjo gjithësi është krijuar vetëm për ato dy gjëra. E ato janë: dituria dhe adhurimi ndaj Allahut Teala (ibadet). Kjo botë (dynja) dhe bota tjetër (ahiret), janë krijuar vetëm për këtë qëllim. Andaj, çdo njeri është i obliguar që t’ia kushtojë jetën dhe potencialin e tij vetëm këtyre dy gjërave, dhe gjithçka që bie ndesh me to është e kotë.”<sup>4</sup>*

## NJERIU DHE VEPRAT

Allahu Teala e krijoi njeriun dhe e stolisi atë me cilësi të shumëllojshme, por edhe nuk e la pa e angazhuar, duke e ngarkuar me disa detyra në këtë jetë botërore. Detyra më e rëndësishme e njeriut ndaj Krijuesit të tij - Allahut Teala, është që Atij t’i bëhet ibadet, dhe që të përmbushet detyra e ibadetit. Allahu Teala krijoi botën dhe qiejt, të gjitha mirësitë në botë, jetën dhe vdekjen, me qëllim provimi se kush do të bëjë vepra më të mira. Ashtu siç thuhet edhe në Kur’an:

**“Ai i ka krijuar vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i Madh.” 67-Mulk: 2.**

---

<sup>4</sup> Gazali, Minhaxhu’l-Abidin, f, 11.

**“Pastaj ju bëmë juve pas tyre zëvendës në tokë, për të parë se si do të veproni.” 10-Junus: 14.**

Duhet të kuptohet se vepra të mira janë ato vepra që përputhen me Sheriatin. Allahu Teala do të nxjerr në shesh se kush bëri vepra më të mira në këtë botë, dhe pa asnjë padrejtësi do të gjykojë njerëzit sipas veprave dhe sjelljeve të tyre në këtë botë.

**“Me siguri, Allahu dhe i Dërguari i Tij do t’i shohin veprat tuaja; pastaj ju do të ktheheni tek Ai, që i di gjërat e padukshme dhe të dukshme, e do t’ju lajmërojnë për atë që keni bërë.” 9-Teube: 94.**

**“Thuaj: ‘Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t’ju njoftojë për atë që keni bërë’.” 9-Teube:105.**

**“Atë ditë askujt nuk do t’i bëhet ndonjë padrejtësi dhe ju do të shpërbleheni vetëm sipas asaj që keni bërë.” 36-Jasin: 54.**

Secili do ta gjej shpërblimin dhe dënimin e asaj çfarë ka bërë në dynja, qoftë edhe sa grimca, dhe më e vogël se ajo:

**“Kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.**

**Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.” 99-Zelzele: 7-8.**

Të gjithë do të dënohen për veprat e tyre të liga, në të njëjtën kohë - vepër-mirët do të shpërblehen shumëfish për punët e tyre të mira.

**“(Këta shpresojnë) që Allahu t’i shpërblejë sipas veprave më të mira që kanë bërë e t’ua shtojë dhuntinë e Tij. Allahu i jep kujt të dojë, pa llogari.”**

24-Nur: 38.

**“As pasuria juaj, as fëmijët tuaj nuk do t’ju afrojnë më shumë te Ne, por vetëm ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira (e meritojnë këtë). Ata do të kenë shpërblim të shumëfishtë për atë që kanë bërë dhe do të jenë të sigurt në banesa të larta (në xhennet).” 34-Sebe: 37.**

**“Ata që bëjnë vepra të këqija, do të dënohen vetëm sipas veprave të bëra; ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, qofshin meshkuj apo femra, do të hyjnë në xhennet. Aty do të begatohen pa kufizim.” 40-Gafir: 40.**

## AMELI SALIH (PUNËT E MIRA)

Fjala amel ka kuptimin e punës, veprim, mundim, të përmbushurit e një urdhëri ose detyre, të zbatuarit e urdhrave të fesë, ibadeti.

Ndërsa fjala salih ka kuptimin: të qenit i mirë, i dobishëm, i vlefshëm, i hajrit, ai që posedon drejtësi dhe veprime të drejta, ai që i zbaton urdhrat e fesë, me dinjitet, i devotshëm.

Pra, shprehja amel dhe salih janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën dhe ai i cili bën vepra të mira në terminologjinë islame njihet si salih. Edhe në Kur'an fjala salih ka të bëjë me atë që është i drejtë në besim, në sjellje, në mënyrën e jetës dhe në vepra të mira.

Andaj, veprat e njerëzve ndahen në vepra të mira, të dobishme, të vlefshme (salih) dhe vepra të këqija. Njëkohësisht, veprat e njerëzve kategorizohen edhe me veçori të tjera si: vepra që bëhen me zemër (bindje), vepra me gjuhë dhe vepra me gjymtyrë.

## LIDHJET MES AMELIT DHE NIJETIT

Puna dhe qëllimi (nijet) janë dy faktorë të pandashëm njëri me tjetrin. Ashtu siç thotë edhe

Pejgamberi s.a.v.s.:

**“Vepra shpërblehet sipas qëllimit...”<sup>5</sup>**

Pra, vepra që bëjmë, merr shpërblimin e merituar nga Allahu Teala, vetëm atëherë kur nijeti është përfitimi i kënaqësisë së Tij.

Në një punë duhet të jenë prezent katër faktorë: dituria, nijeti, durimi dhe singëriteti. Pra, para së gjithash duhet pasur dituri se si duhet të bëhet ajo punë, më pas duhet të dihet qëllimi se për çfarë bëhet puna, durimi shërben për këmbëngulje në realizimin e qëllimit - pavarësisht vështirësive që hasim gjatë rrugës, dhe singëriteti na mundëson të ruhem nga hipokrizia në punët tona.

---

<sup>5</sup> Buhariu, Iman, 41, Bid`u`l-vahj, 1,45, Nikah, 5; Muslim, Imaret, 45; Ebu Davud, Talak, 11; Tirmizi, Xhihad, 16; Nesai, Taharet, 60; Ibn Maxhe, Zuhd, 26 (nr. 4227)

## Para së gjithash.....

Imam Rabbani në letrën që i dërgoi një nxënësi të tij, në lidhje me punët që duhet të kryhen në rrugën e Allahut, ndër të tjera shkruan:

*“Së pari, njeriu duhet ta drejtojë besimin përshtatshëm me besimin e dijetarëve të Ehl-i sunnet ve `l-xhematit, që njihen si grupi i të shpëtuarve.*

*Dhe së dyti, duhet të mësojmë rregullat e fikh-ut (juridiksionit islam), ku përfshihen: farzet, sunnetet, mustehabet, të lejuarat (hallall), të ndaluarat (haram), mekruhet (vepër e cila është afër haramit, e papëlqyer) dhe të gjitha gjërat e dyshimta sipas juridiksionit islam. Duke përdor mësimet e fikh-ut, i bëjmë punët e mira (sali amel), në mënyrën e duhur. Pasi që përfitohen këta dy krahë, besimi dhe puna sipas fikh-ut, dhe nëse Allahu Teala dëshiron, atëherë është i mundur fluturimi në botën e hakkikat-it.*

*Përndryshe, ngritja në atë botë të lartë është e pamundur pa këta dy krahë: besim të drejtë dhe punë të mirë.”<sup>6</sup>*

*“Puna e parë që duhet të bëhet është mësimi i rregullave të namazit, farzet, vaxhibet, sunnetet, mustehabet, nafilet. Në lidhje me këto rregulla, duhet të takoheni shpesh me njerëzit e dijes dhe ti pyesni ata. Kjo, për shkak se namazi është shtylla e fesë, drita e dijetarëve. Namazi është zbukurimi dhe grada e afërsisë së dijetarëve.”*

Ebu Nasr es-Serraxh

---

<sup>6</sup> Imam Rabbani, Mektubat, 237

# ILMIHAL

## TAHARETI - PASTËRTIA

*Taharet* do të thotë pastërti. Pastërtia fizike/materiale dhe psikike/shpirtërore ndahet në dy pjesë:

### **Pastrimi hades**

Gjendja e papastërtisë trupore dhe shpirtërore që detyron marrjen e abdesit dhe gusulit quhet hades. Kur jemi në gjendje të papastër nga ejakulim i spermës (xhenabet), menstruacionet tek femrat (hajiz) dhe koha pas lindjes (nifas), me marrjen e abdesit, e më pas gusulit, bëhet pastrimi i hadesit.

### **Pastrimi nexhaset**

Gjërat që nuk janë të pastra, që janë të pista, në fe quhen nexhaset. Për të qenë namazi i pranueshëm tek Allahu Teala jemi të obliguar të kemi trupin e pastër, rroba të pastra dhe vendin ku falemi të pastër.

## RËNDËSIA E PASTËRTISË NË ISLAM

Pastërtia në islam zë një vend shumë të rëndësishëm. I gjithë legjislacioni islam është i ndërtuar mbi faktorin pastërti. Prandaj edhe librat e fikh-ut dhe haditheve fillojnë po me temën e pastërtisë.

Pastërtia, sipas fesë islame jo vetëm që është kusht për ibadetet, por ajo është edhe pjesë e shëndetit tonë.

Në të njëjtën kohë, pastërtia është edhe njëri nga faktorët kyç për ta fituar kënaqësinë e Allahut Teala. Ashtu siç thuhet në Kur'an:

**“(Padyshim) Allahu i do të pastrit.”**

9-Teube: 108.

Gjithashtu, edhe Resulallahu s.a.v.s. në lidhje me rëndësinë e pastërtisë thotë:

**“Pastërtia është gjysma e imanit”<sup>7</sup>**

Feja islame e bën të qartë rëndësinë që ajo i jep pastërtisë.

---

<sup>7</sup> Muslim, Taharet, 1

## PASTËRTIA E ZEMRËS

Ekzistojnë dy lloj pastërti: e para është pastërtia e trupit, edhe e dyta ajo e zemrës. Ashtu siç nuk njihet namazi pa abdes, po ashtu edhe pa pastrimin e zemrës nuk realizohet njohuria e vërtetë.

Ashtu siç pastrohet trupi me ujë të pastër, po ashtu edhe zemra pastrohet me teube dhe tehvid të pastër. Ashtu siç merret abdesi i jashtëm (zahir) me ujë, edhe abdesi i brendshëm (batin) bëhet i mundshëm - me teube dhe me kthim tek Haku.

Gjynahet janë ndyrësi psikike/shpirtërore, që e njollosin zemrën dhe shpirtin. Për t'u pastruar prej këtyre ndyrësirave, për pastrim shpirtëror janë: teubeja, istigfari, dhikri (përmendja, përkujtimi), duaaja dhe veprat e mira.

Andaj, duke kërkuar falje dhe mëshirë, me pendim të sinqertë për gjynahet tona, e pastrojmë shpirtin dhe zemrën tonë. Ai që bën pendim të sinqertë tek Allahu Teala për gjynahet/gabimet e tij, pastrohet nga gjynahet e bëra. Ai që bën mirë për hir të Allahut, i shlyhen gjynahet.

Pra, Allahu Teala robit të Tij i jep mundësinë për pastrim nga gjynahet dhe arritjen e kënaqësisë shpirtërore në të dy botët.

## PËR NJË NAMAZ NË QETËSI SHPIRTËRORE

Për të qenë i koncentruar në namaz duhet të marrim abdes me një kujdes të veçantë, ngase abdesi që merret shkel-e-shko ndikon në përqendrim gjatë faljes së namazit.

Në lidhje me këtë, Shejh Abdurrahman Tahi thotë:

*“Mos-përqendrimi në namaz është i lidhur direkt me mënyrën e marrjes së abdesit dhe me pastërtinë gjatë kryerjes së nevojës. Kur myslimani përgatitet për të marrë abdes duhet ta di se ai po del para Allahut Teala, Krijuesit të gjithësisë, andaj duhet të jetë i pastër nga pa-pastërtia e dukshme dhe e padukshme.*

*Edhe kur merr abdes, duhet ta dijë që abdesi është faktori i pastërtisë shpirtërore dhe parapërgatitje për të hyrë në namaz.”<sup>8</sup>*

---

<sup>8</sup> Abdurrahman-i Tahi, el-Isarat, f. 174

## RREGULLAT KUR SHKOJMË NË TUALET

Para se të hymë në tualet, duhet të kërkojmë mbrojtje nga shejtani me eudhu-billahi-minesh-shejtani-rraxhim dhe ta themi duanë: "*Allahumme inni eudhu bike mine 'l-hubthi ve 'l-habaith*" ("Allahu im, më mbroj nga xhinët meshkuj dhe femra").

Në tualet duhet të hyhet me këmbën e majtë dhe duhet të dilet me këmbën e djathtë.

Gjatë shkuarjes në tualet, duhet të largohet nga trupi çdo gjë e cila përmban emrat e Allahut, apo diçka të fesë.

Në tualet, nuk është mirë të hyhet me çorapë, me pallto të gjatë, dhe gjithçka e cila mund të përlyhet gjatë kryerjes së nevojës.

Nuk është mirë që të kryhet nevoja në këmbë dhe në drejtim të kiblës.

Në tualet, nuk është mirë të flitet, të qëndrohet shumë, të lexohet gazetë etj.

Nuk është mirë të pështyhet, nuk duhet shikuar organin seksual.

Kur jemi jashtë, duhet pasur kujdes gjatë kryerjes së nevojës, në mënyrë që mos ta pengojmë askënd dhe mos të shihemi nga të tjerët.

Nuk duhet të kryhet nevoja në ujë (lumë, përroskë), mur, varreza, rrugë dhe të ngjashme.

Ata që kanë dyshime (janë vesvese) për rrjedhje të mundshme të urinës, për të mos u bërë peng i vesveses, pasi të bëjnë pastrimin, duhet të hedhin pak ujë mbi veshjen e brendshme.

Gjatë kryerjes së nevojës nuk guxojmë të spërkatemi me urinë.

Pas pastrimit të organit me ujë, nëse kemi façetë apo diç të ngjashme, mund të fshihemi me të.

Kur të dalim nga tualeti, duhet thënë: *“Gufraneke”* (Allahu im, më fal mua).

Nuk duhet të merret abdesi përderisa nuk je i sigurt që urina është ndërprerë.

Pasi që të dilet nga tualeti, duart duhet pastruar me ujë.

## ISTINXHA DHE ISTIBRA

Me fjalën istinxha nënkuptojmë pastrimin e pjesës së caktuar të trupit pas kryerjes së nevojës së madhe ose të vogël.

Në mungesë të ujit mund të përdoren gjethe, gurë, letër tualeti dhe të ngjashme.

Ndërsa me fjalën istibra, nënkuptojmë që duhet të pritet pak pas urinës, të jemi të sigurt se nuk do të ketë rrjedhje nga organi pas urinimit. Istinxha - pastrimi i organit, bëhet atëherë kur jemi të sigurt që nuk ka më rrjedhje.

## ABDESI

Abdesi është pastrim i pjesëve të caktuara të trupit para se ti drejtohem Allahut Teala nëpërmjet namazit. Abdesi është kusht për namaz-falësin. Marrja e abdesit, pos pastrimit të pjesëve të trupit, njëkohësisht pastron dhe përgatit shpirtin e namaz-falësit për të dalë para Allahut.

Njeriu, edhe kur bën keq edhe kur bën mirë, përdorë gjymtyrët e trupit të tij. P.sh. njeriu përmes dorës kryen shumë veprime, përmes gojës ushqehet dhe flet, përmes hundës merr erëra të ndryshme, me sy shikon, me krah bartë, me vesh dëgjon, me këmbë ecën, etj... Këto veprime që realizohen me gjymtyrë mund të jenë të mira ose të këqija, që aludon në atë se me gjymtyrë mund të fitohet sevap ose të hyhet në gjynah.

Andaj, gjatë marrjes së abdesit lutemi në brendinë tonë për pastrim nga gjynahet e bëra me ose pa qëllim. Në fillim bëhet nijeti, që nënkupton edhe përgatitjen shpirtërore për të hyrë në namaz, dhe fillon marrja e abdesit:

- Lahen duart deri te nyjat e duarve. (tri herë)
- Kur e fusim ujin në gojë (tri herë) lutemi:  
*“O Allah, ma mundëso që ta përmend emrin tënd me lehtësi dhe dashuri ndaj Teje”*
- E kur e fusim ujin në hundë (tri herë) lutemi:  
*“Allah, më mundëso që hunda ime ta nuhas erën e xhennetit, e më ruaj nga era e xhehenemit”.*
- Kur e lajmë fytyrën (tri herë) lutemi:  
*“O Allah, ma zbardho fytyrën time me dritën Tënde në ditën e gjykimit, e mos ma nxij atë”.*
- Kur e lajmë krahun e djathtë (tri herë) thuhet:  
*“O Allah, më bëj nga ata që iu jepet libri nga dora e djathtë dhe ma lehtëso llogarinë”.*
- Gjatë larjes së krahut të majtë (tri herë) thuhet:  
*“Allah, mos më bëj nga ata që iu jepet libri nga e majta dhe ma lehtëso llogarinë në ditën e gjykimit”.*
- Kur i japim mes’h (lëmojmë) kokës (një herë) thuhet:  
*“O Allahu im, më mbulo me mëshirë, zbrit bereqet, njohuri dhe hije në ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Arshit.”*

- Kur i pastrojmë veshët (një herë) thuhet:  
*“O Allahu im, ma mundëso që të jem nga ata të cilët i dëgjojnë dhe praktikojnë urdhrat tua, dhe më bëj që ta dëgjoj thirrjen për në xhennet”.*
  
- dhe kur të lahet qafa (një herë) themi:  
*“Allah, më ruaj nga zinxhirët e xhehenemit”.*
  
- Ndërsa, gjatë larjes së këmbëve (tri herë) thuhet:  
*“O Allahu im, bëj që unë të jem i qëndrueshëm, si një nga ndjekësit e rrugës tënde të drejtë”.*
  
- Pas abdesit, shqiptojmë shehadetin dhe bëjmë duanë:  
*“Allahu im, njeriu i bën keq vetes; edhe unë mund ta kem bërë ndonjë gjynah. Unë pendohem me pendim të sinqertë tek Ti, për faljen e gjynahut. Më fal mua, prano lutjet e mia, ngase Ti e do pendimin, ja Rabbe`l-alemin. Më pastro nga gjynahet dhe më bëj prej robërve të penduar, më bëj prej atyre që falënderojnë shumë, durojnë dhe të përmendin Ty ja Rabbe`l-ale min”.*

Ashtu siç uji pastron papastërtinë, edhe pendimi i sinqertë pastron gjynahun e bërë.

## FARZET E ABDESIT

Abdesi ka katër farze.

- 1) Larja e fytyrës.
- 2) Larja e duarve deri në bërryla.
- 3) Dhënia mes'h<sup>9</sup> 1/4-tës së kokës.
- 4) Larja e këmbëve deri në nyje (zog) të shputës.

---

<sup>9</sup> Mes'hi është lëmim me dorë të lagur mbi mest'et (mbathjet e lëkurës) dhe mbi ndonjë pjesë të trupit që është e mbështjellur me fashë, të cilën për shkak të plagës ose lëndimit nuk mund ta pastrojmë.

## SUNNETET E ABDESIT

Sunnetet e abdesit janë këto:

- Bërja nijet për të marr abdes.
- Fillimi i abdesit me “Euzu besmele” (ose “*Bismillah vel hamdulillah ala dinil Islam*”)
- Larja e duarve deri në nyje.
- Larja e dhëmbëve me misvak.
- Larja/shpëlarja e gojës 3 herë.
- Larja e hundës 3 herë.
- Larja e pjesëve të trupit nga 3 herë.
- Kompletimi i abdesit, pa ndërprerje.
- Pastrimi i mirë i pjesëve të trupit, gjatë abdesit.
- Larja e pjesëve të trupit duke filluar nga e djathta.
- Gjatë larjes së duarve dhe këmbëve, fillimi i larjes nga gishtërinjtë.
- Gjatë larjes së duarve, lëvizja e unazës, në mënyrë që të depërtojë uji në të gjitha pjesët e dorës.
- Dhënia mes`h veshëve.
- Dhënia mes`h qafës.
- Dhënia mes`h gjithë kokës.
- Gjatë larjes së duarve, fërkimi ndërmjet gishtave.
- Përshkimi/fërkimi i mjekrës me gishtërinj të lagur.
- Larja e pjesëve të trupit sipas radhës.

## MUSTEHABET (TË PREFERUARAT) E ABDESIT

- Marrja e abdesit, para hyrjes së kohës së namazit.
- Kthimi kah kibla.
- Ulja në ulëse, në mënyrë që mos të stërpikemi.
- Mos-kërkimi ndihmë nga të tjerët gjatë marrjes së abdesit.
- Gjatë abdesit, nuk është mirë të flitet, nëse nuk është e domosdoshme.
- Përdorimi i ujit me masë, pa e tepruar.
- Nuk preferohet përplasia e ujit në fytyrë.
- Lëvizja e unazës, nëse keni.
- Larja e këmbëve me dorën e majtë.
- Këndimi i duave, gjatë larjes së pjesëve të trupit.
- Fshirja e hundës me dorën e majtë.
- Futja e ujit në gojë dhe hundë me dorën e djathtë.
- Dhënia mes`h e veshëve me gishtat e vegjël.
- Këndimi i sures el-Kadr, pas abdesit.
- Falja e dy rekateve, pas marrjes së abdesit<sup>10</sup>.
- Gjatë marrjes së abdesit, të mos harrohet nijeti i abdesit, dhe të jemi të vetëdijshëm që jemi duke marrë abdes.
- Larja e çdo pjese të trupit duke thënë bismil-lah.

---

<sup>10</sup> Sipas medh'hebit Hanefi, falja e dy rekateve pas marrjes së abdesit nuk lejohet në kohën e *kerahetit* (kur dielli është duke lindur; ne mesditë).

## GJËRAT QË E PRISHIN ABDESIN

- 1) Çdo gjë që del nga organet e jashtëqitjes (kryerja e nevojes së madhe apo të vogël, gazrat, etj...)
- 2) Rrjedhja e gjakut ose qelbit nga trupi.
- 3) Vjellja me plot gojën.
- 4) Pështymja me gjak.
- 5) Humbja e vetëdijes.
- 6) Qeshja në namaz aq sa vërehemi nga të tjerët.
- 7) Gjumi, apo kotja.
- 8) Për ata që kanë rrjedhje të vazhdueshme nga trupi, qoftë nga plaga ose diçka tjetër, përfundimi i namazit nënkupton edhe prishjen e abdesit. Njerëzit e tillë duhet patjetër të ripërtërijnë abdesin për namazin e ardhshëm.
- 9) Për ata të cilët kanë marrë tejemmum, abdesi prishet me gjetjen e ujit.

## PUNËT QË NUK MUND TË KRYHEN PA ABDES

- 1) Falja e namazit.
- 2) Sexhdja e Kur'anit – tilaueti.
- 3) Tavafi në Qabe.
- 4) Prekja e Kur'anit (nëse nuk është i mbështjellur me diçka tjetër).

## GUSULI (LARJA E TËRË TRUPIT)

Me gusul nënkuptojmë larjen e gjithë trupit, duke mos lënë asnjë pjesë të pa lagur.

Gusuli ndonjëherë është farz, ndonjëherë sunnet, dhe ndonjëherë është mendup (e rekomanduar). Marrja e gusulit për xhunub, është farz.

Marrja gusul për namazin e xhumasë, bajramit, apo gjatë veshjes së ihramit në haxh është prej sunneteve.

Edhe të bërit gusul një herë në javë, me qëllimin të pastrimit, është sunnet.

Ndërsa, rekomandohet marrja e gusulit me qëllim të pastrimit, freskimit apo për të bërë ibadet.

## KUR DUHET TË MERRET GUSULI

- 1) Pas marrëdhënieve seksuale, pavarësisht ejakulimit ose mos ejakulimit, qoftë nga femra apo mashkulli, marrja e gusulit është farz (kusht).
- 2) Ejakulimi në ëndërr. Pasi të ngihemi nga gjumi, marrja e gusulit është farz.
- 3) Për femrat me menstruacione (hajz) apo në periudhën pas lindjes, marrja e gusulit është farz.
- 4) Dhënia gusul xhenazes, me përjashtim të dëshmorit (shehidit), është nga farzet kifaje.

## FARZET E GUSULIT

- 1) Futja e ujit në gojë dhe gurgullitja e tij. Shpëlarja e gojës dhe fytit;
- 2) Futja e ujit në hundë - shpëlarja e hundës;
- 3) Larja e plotë e trupit (duke mos e lënë asnjë pjesë të trupit pa u lagur).

## SUNNETET E GUSULIT

- Fillimi me bism-ilah.
- Fillimisht lahen pjesët që përmbajnë papastërtinë.
- Marrja e abdesit, para fillimit të gusulit.
- Nijeti për gusul.
- Larja e duarve deri në byzylyk.
- Larja e organit.
- Hedhja e ujit mbi trup 3 herë duke e fërkuar atë me shumë kujdes.
- Fillimi i larjes së trupit nga koka, për të vazhduar me larjen e anës së djathtë të trupit, pastaj anën e majtë.
- Fërkimi i trupit menjëherë pas hedhjes së parë të ujit.
- Larja në një vend ku nuk shihesh nga të tjerët.
- Pa ndonjë nevojë, mos-folja gjatë larjes.
- Gjatë marrjes së gusulit, nuk bën të kthehemi nga ana e kiblës.

- Mbulimi i organit (edhe nëse je vetëm).
- Përdorimi i ujit me masë.
- Pas gusulit, tharja e trupit me ndonjë peshqir.
- Veshja me rroba menjëherë pas marrjes së gusulit.

## GJËRAT E NDALUARA KUR JEMI PA GUSUL

- 1) Falja e namazit.
- 2) Bërja e sexhdes së Kur'anit.
- 3) Leximi i Kur'anit.
- 4) Prekja e Kur'anit.
- 5) Ulja dhe qëndrimi në xhami.
- 6) Bërja e tavafit në Qabe.
- 7) Agjërimi i Ramazanit.
- 8) Hyrja në marrëdhënie seksuale.<sup>11</sup>

---

<sup>11</sup> Pikat shtatë dhe tetë janë vetëm për femrat kur gjenden në periudhën e menstruacioneve (hajz) dhe periudhën pas lindjes (nifas).

## TEJEMMUMI

Në të gjitha rastet kur nuk mund të gjejmë assesi ujë, kur kemi ujë vetëm për nevojat themelore jetësore, kur jemi të sëmurë dhe nuk mund të marrim abdes apo gusul, në gjendje të tilla në vend të abdesit dhe gusulit duhet të marrim tejemmum. Tejemmumi, njësoj si abdesi dhe gusuli, është farz.

Tejemmumi është larje simbolike me dhé të pastër ose me mjete nga esenca e dheut (qerpiçi, tulla)

Çështjet që duhet të dihen në lidhje me tejemmumin janë këto:

- Shqiptojmë bism-ilah dhe bëjmë nijetin: *Në emër të Allahut Teala vendosa të marr tejemmum për (në vend të) abdes ose për (në vend të) gusuli.*
- Me shuplaka prekim dheun e pastaj lëmojmë (fërkojmë) fytyrën.
- Përsëri me shuplaka prekim dheun dhe me shuplakë të majtë lëmojmë krahun/dorën e djathtë e me shuplakë të djathtë krahun e majtë deri në bërryla.

Më tejemmumin që merret për abdes ose për gusul, mund të falen namazet, si farz ashtu edhe nafile. Çdo gjë që e prish abdesin dhe gusulin e prish edhe tejemmumin. Vetëm se, kur gjendet ujë për abdes dhe gusul - tejemmumi prishet, duhet të merret abdes dhe gusul me ujë.

## NAMAZI DHE RËNDËSIA E TIJ

Namazi është të drejtuarit Allahut Teala.

Namazi është miraxhi i muminit.

Namazi është rrugëtimi shpirtëror i krijesës njeri, drejt Krijuesit të tij, Allahut Teala.

Namazi është ngritje shpirtërore e njeriut.

Namazi afron robin Allahut Teala.

Robi që lartësohet - pjekët, pastrohet prej veseve të këqija, bëhet njeri i mirë.

Namazi i jep forcë trupit, qetëson dhe i jep kënaqësi shpirtit të krijesës njeri dhe është prej veprave (amel) më të vlefshëme.

Namazi është shtylla e fesë.

*“Bëhu edhe fakih edhe sufi, mos u mjafto vetëm me njërën.*

*Mos u tendos miku im, ngase kjo është këshillë për ty.*

*Nuk mund të shijohet devotshmëria, nëse je vetëm fakih, e nëse je vetëm sufi, mbetesh injorant.”*

Imam Shafiu

## JU, SI E FALNI NAMAZIN?

Njëri e pyeti Hatim-i Esamin:

-Si e falni Ju Namazin?

Ai u përgjigj:

*-Kur të vjen koha e namazit, marr abdesin dhe pastrohem nga ndyrësira e brendshme dhe e jashtme. Pastroj pjesët e trupit me ujë, ndërsa brendësinë time me teube (pendim). Më pas shkoj në xhami. Në xhami e sjell para sysh Mesxhid-i Haram-in, Xhennetin në të djathtë, Xhehenemin në të majtë, Urën e Siratit nën këmbët e mia ndërsa melaiken e vdekjes mbrapa meje dhe i dorëzoj zemrën Allahut Teala.*

*Më pas, me respektin më të madh marr tekbir duke qëndruar në këmbë, i nënshtroar lexoj Kur'an, me modesti bie në ruku, i përlurur bie ne sexhde, rri në tehejjat, dhe duke e falënderuar Allahun Teala jap selam.<sup>12</sup>*

---

<sup>12</sup> Ebu Nuajm, Hiljetu`l-Evlja, 8/74; Gazali, Ihjau Ulumi`d-din, 1/270; Suhreverdi, Avarifu`l-Maarif, f.324. Attar, Tezkire, s. 99; Bursevi, Ruhu`l-Bejan, 1/33.

*"Thuaj:  
'Namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime  
janë thjesht për Allahun, Rabbin e botëve."*

6-En'amë: 162

## KUSHTET DHE RUKNET E NAMAZIT

Namazi është ndër ibadetet më të rëndësishme në islam. Ai që fal namazin gjen kënaqësinë e Allahut Teala. Për këtë arsye, nuk mund të falim namaz përderisa nuk i dimë rregullat dhe kushtet e faljes apo daljes para Allahut Teala. Pra, duhet të njihemi me farzet, vaxhibet, sunnetet dhe ruknet e namazit.

Për t'u bërë namazi farz për një njeri, mjafton që ai t'i plotësojë këto tri kushte:

- 1) Të jetë mysliman.
- 2) Të jetë i vetëdijshëm.
- 3) Të jetë i moshës madhore.

## KUSHTET DHE FARZET E NAMAZIT

Namazi ka 12 farze. Këto ndahen në dy grupe: 'farzet e jashtme' dhe 'farzet e brendshme'.

Farzet e jashtme të namazit quhen edhe "kushtet e namazit", për shkak se vijnë para namazit dhe përbëjnë përgatitjen në namaz.

Ndërsa farzet e brendshme quhen "ruknet e namazit" pasi që përbëjnë esencën e namazit.

Të gjithë këta faktorë së bashku përbëjnë namazin. Nëse vetëm një prej farzeve të namazit mungon, namazi nuk është i vërtetë.

### **Kushtet e namazit janë:**

- 1) *Pastrimi prej hadesit*: Marrja e abdesit dhe gusulit, për pastrim prej gjendjes së papastër psikike dhe shpirtërore.
- 2) *Pastrimi prej nexhasetit*: Pastrimi i tërë trupit, rrobave dhe vendit ku falim namazin.
- 3) *Setr-i avrat*: Të qenit veshur/mbuluar sipas rregullit.
- 4) *Istikbal-i kible*: Të kthyerit kah Kibla kur falim namazin.
- 5) *Koha*: Të falurit në kohën e duhur.
- 6) *Nijeti*: Të bërit nijet cilën kohë të namazit po e falim.

### **Ruknet e namazit:**

- 1) *Iftitahi tekbir*: Tekbiri fillestar, të fillohet namazi duke thënë “Allahu Ekber”.
- 2) *Kijam*: Qëndrimi në këmbë.
- 3) *Kiraet*: Leximi i Kur’anit në namaz.
- 4) *Ruku*: Përkulja në namaz.
- 5) *Suxhud*: Të rënit në sexhde.
- 6) *Kade-i ahire*: Qëndrimi i fundit në tehiyyat.

## LLOJET E NAMAZIT

### **Namazet farz**

Namazet farz, ndahen në farzi ajn dhe farzi kifaje. Farz-i ajn është obligim për të gjithë myslimanët e moshës madhore (falja e pesë vakteve dhe xhumaja). Ndërkaq, namazi kifaje, është namaz i cili nëse falet nga një grup i myslimanëve, pjesa tjetër lirohet nga obligimi, siç është rasti me namazin e xhenazes.

### **Namazet vaxhib**

Në medh'hebin Hanefi vaxhib konsiderohet vitri i jasisë, dhe namazi i Bajramit<sup>13</sup>. Po ashtu në këtë grup bën pjesë edhe sexhdja e Kur'anit dhe sehvi sexhdja (sexhde gabimi).

### **Namazet nafile**

Namazet që falen jashtë namazeve farze dhe vaxhibe quhen namaze nafile. Edhe namazet nafile ndahen në dy pjesë: sunnet dhe mustehab.

---

<sup>13</sup> Sipas medh'hebit Shafi, vitri i Jasisë dhe namazi i Kurban Bajramit janë prej namazeve sunnet.

*Namazi është farz për të gjithë. Është një farz i cili nuk guxon të lihet anash për asnjë moment, as edhe në momente të jashtëzakonshme. Mos-falja e namazit dënohet ashpër nga Allahu Teala; sipas disa dijetarëve për mos-faljen e namazit pasojnë 500 vite dënim, e sipas disa të tjerëve 70.000 vite.*

*Edhe atëherë kur myslimani është aq i sëmurë sa që nuk lëvizë, është i obliguar që ta fal atë (përderisa ka vetëdije), me anë të shenjave. Edhe nëse myslimanit i humbë vetëdija gjatë kohës së namazit, ai është i obliguar që ta bëjë kaza."*

Shejh Sejjid Abdulbaki el- Husejni

## Namazet sunnet

- Sunnetet të cilat falen vazhdimisht gjatë pesë kohëve të namazit ditor quhen *ravatib*. Ato janë:
- Dy rekate sunnet para farzit të sabahut.
- Katër rekate sunnet para dhe dy rekate sunnet pas farzit të namazit të drekës.
- Katër rekate sunnet para farzit të ikindisë.
- Dy rekate sunnet pas farzit të akshamit.
- Katër rekate sunnet para dhe dy rekate sunnet pas farzit të jaciesë.

Edhe namazet e sunnetit ndahen në dy grupe:

Sunnetet muekked: të sabahut, drekës, akshamit dhe dy rekatet e fundit të sunnetit të jaciesë.

Ndërsa, ato që nuk janë sunnet muekked janë: katër rekatet sunnet para farzit të ikindisë dhe jaciesë.

## Namazet mustehab

Përpos sunneteve *ravatib*, namazet nafile quhen *regaib*. Këto janë namazet të cilat Pejgamberi s.a.v.s. nuk i ka falur vazhdimisht, ose i ka falur në raste të caktuara. Këto janë namaze të cilat mbeten në dëshirën e njeriut, për të cilat - nëse falen ka shpërblim, por nëse nuk falen nuk ka dënim. Këto namaze vullnetare, quhen edhe si namazet “tatavvu”. Këto janë namaze mustehab dhe mendub. Në këtë grup, prej namazeve nafile *regaib* janë: namazi i

duhasë, tehijjetu'l-mesxhid, namazi i pendimit (teubes), namazi evvabin, namazi tesbih, namazi kusuf (namaz i cili falet gjatë zënies së diellit), namazi i istihares, namazi i shiut, namazi gjatë veshjes së ihramit, namazi i udhëtimit, namazi pas marrjes së abdesit dhe gusulit.

## KOHA E NAMAZEVE FARZ

Namazi është njëra ndër shtyllat kryesore të islamit. Ky obligim kryhet në kohë të caktuar. Andaj, kryerja apo falja e namazeve ditore në kohën e vet është nga kushtet e namazit. Andaj edhe Allahu Teala thotë:

**“Sepse namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar.”** 4- Nisa: 103.

Pra, falja e namazit para ose pas kohës së tij, nuk është i lejueshëm.

### **Koha e namazit të sabahut**

Koha e namazit të sabahut fillon që nga agimi i dytë dhe zgjat deri në lindjen e diellit. Pra, me hyrjen e agimit fillon koha e namazit të sabahut dhe del koha e namazit të jacisë.

## **Koha e namazit të drekës**

Koha e namazit të drekës apo mesditës fillon nga momenti që dielli lëviz prej zenitit dhe vazhdon deri në atë pozitë kur hija e cilitdo objekt fiton gjatësinë e tij.

## **Koha e namazit të ikindisë**

Namazi i ikindisë fillon me të dalë koha e namazit të drekës dhe vazhdon deri në perëndimin e diellit.

## **Koha e namazit të akshamit**

Namazi i akshamit fillon nga momenti i perëndimit të diellit, dhe vazhdon deri në errësimin e horizontit.

## **Koha e namazit të jacisë**

Namazi i jacisë fillon që nga errësimi i plotë i horizontit dhe vazhdon deri para agimit.

*“Qëllimi i tasavvufit është fitimi i kënaqësisë së Allahut Teala; është kryerje e urdhrave të Tij.*

*Tasavvufi është zemra e islamit. Është i bardhë sikur bardhësia e qumështit; edhe një njollë shumë e vogël vërehet në të; (andaj) duhet të jesh shumë i kujdesshëm.*

*Dobia më e madhe e tasavvufit dhe dijetarëve të zgjedhur (sadati kiram) shihet në frymën e fundit.”*

Shejh Sejid Abdulbaki el- Husejni

## TASAVVUFI DHE QËLLIMI

Sufitë, tasavvufin e kanë shpjeguar në shumë mënyra:

Tasavvuf është moral i lartë, është pastrim i zemrës, është zbatimi i edukatës. Tasavvuf është nënshtrimi pa kundërshtim urdhrave hyjnorë. Tasavvuf është largimi dhe ruajtja e shpirtit nga kënaqësitë iluzore të kësaj bote. Tasavvuf është shfrytëzimi dhe vlerësimi i kohës. Tasavvuf është të qenit i mbuluar me moralin që e do Allahu Teala. Tasavvuf do të thotë të mos i bëjmë dëm dhe mos ta bëjmë të vuaj asnjë krijesë të Allahut, mos të jemi ankues ndaj sprovave që vijnë nga Allahu Teala, të jemi falës ndaj atyre që na bëjnë keq - përpjekje për të arritur shkallën më të lartë të etikës njerëzore. Tema e tasavvufit është njeriu, qëllimi i tasavvufit është zbukurimi i njeriut me moralin hyjnor. Si përfundim i këtij qëllimi është ngritja e njeriut në pjekuri dhe përsosmëri. Esenca e tasavvufit është të bërit vepra (amel) sipas urdhrave të ajeteve dhe haditheve, të jetuarit sipas sunnetit të Pejgamberit s.a.v.s., qëndrimi larg prej bidateve risive në fe (bidat), largimi nga dëshirat e epshit dhe kontrollimi i tij, përmbajtja nga komentimi i urdhrave hyjnor të fesë sipas kuptimit vetanak, dhe largimi nga kërkimi i lehtësimeve në zbatimin e këtyre urdhrave.

## KUSH ËSHTË SUFI?

Fjala “sufi” dhe ‘tasavvuf’ i është dhënë si epitete një shoqërie, gjendja dhe rruga e të cilëve ishte e famshme.<sup>14</sup> Fjalët sufi dhe tasavvuf nuk janë të përmendura në ajete Kur’anore dhe hadithe të Pejgamberit s.a.v.s.. Por, si përmbajtje, është një sistem i krijuar i edukatës, që ka bazë në Kur’an dhe hadith. Në Kur’an, në vend të fjalës ‘sufi’ është përmendur shprehja ‘mukarreb’. Sufiu i vërtetë është mukarreb. Mukarreb është besimtari i devotshëm i dashur nga Allahu, që ka përjetuar dhe ka arrit afërsi në prani hyjnore. Ata janë më përpara në mirësi, janë në majat të ibadetit dhe edukimit. Pra, sufiu i vërtetë është ai që posedon këto cilësi “mukarreb” dhe gjendet në gradën ‘kurbijet’ (afërsi).<sup>15</sup> Prandaj, kur thuhet ‘sufi’ nënkuptohet evliaja që është ngritur në gradën mukarrebun.

Ata që nuk e pranojnë tasavvufin për shkak se nuk është përmendur në Kur’an dhe sunnet me termin sufi dhe tasavvuf, kanë të drejtë, por nëse e mohojnë kuptimin dhe ahlakun (moralin) që përmban tasavvufi, e kanë mohuar tërë fenë dhe tërë moralin e bukur që e solli Pejgamberi s.a.v.s..<sup>16</sup>

---

<sup>14</sup> Kuseyri, Risale, f. 279.

<sup>15</sup> Suhreverdi, Avarifu’l-Maarif, f. 18.

<sup>16</sup> Huxhviri, Keshfu’l-Mahxhub, f. 54.

## HAPI I PARË NË TASAVVUF

Hapi i parë dhe më i rëndësishmi në tasavvuf është pastrimi i zemrës. Në Kur'an pastrimi i zemrës është cekur me emrin 'tezkije', dhe shpëtimi i përjetshëm është i lidhur me të:

**"Ka shpëtuar ai që është pastruar.**

**Që përkujton madhërinë e Rabbit të vet dhe falet."** 87-A'ëla: 14-15.

**"Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten.**

**E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten."**

91-Shems: 9-10.

Edhe misioni i Pejgamberit s.a.v.s. është komunikimi i shpalljes dhe pastrimi i zemrave (tezkije):

**"Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta, nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kur'anin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin krejtësisht të humbur."**

3-Imran: 164.

**"Ai është që analfabetëve u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ju lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme."**

62-Xhuma: 2.

Tezkije ka kuptimin e pastrimit të zemrës nga mosbesimi (shirk), kufri, rebelimi, gafleti, armiqësia, e të ngjashme papastërti të cilat ndikojnë në vdekjen e saj. Ky pastrim arrihet me besim të fortë (iman), nur, njohuri, istigfar, pendim, dënese nga frikë-respekti dhe me ibadet. Pastrimi i zemrës dhe morali i ngritur, në Kur'an quhet devotshmëri (takva). Nuk mund të arrihet pastrimi i vërtetë i zemrës, përderisa nuk pastrohem nga gjynahet që kemi në zemër. Ashtu siç thotë edhe Allahu Teala:

**“Dhe mos bëni gjynahe as haptas as fshehtas.**

**Ata që bëjnë gjynahe do të ndëshkohen për gjynahun e bërë.”** 6-En'am: 120.

Allahu kërkon nga ne që të largohemi nga gjynahet, pavarësisht nga lloji i tij. Edhe hadithet e Pejgamberit s.a.v.s. na bëjnë me dije se baza kryesore e fesë dhe e moralit të islamit tek myslimani është zemra. Ai thotë:

**“Në trupin e njeriut është një pjesë, që nëse ajo (pjesë) është e mirë, i gjithë trupi është i mirë. Por, nëse ajo është e sëmurë (prishur), i gjithë trupi është i sëmurë. Keni kujdes pra, ajo është zemra”.<sup>17</sup>**

---

<sup>17</sup> Buhariu, Iman, 39; Muslim, Kusakat, 107; Ibn Maxhe, Fiten, 14.

Ashtu siç obligohet çdo mysliman për besim të pastër dhe adhurim të drejtë, po ashtu obligohet edhe për pastrim të zemrës, edukim dhe moral të mirë.

## EDUKATA DHE TASAVVUFI

Tasavvufi është sistem edukativ të cilin e praktikoi vetë Pejgamberi s.a.v.s.. Allahu Teala në qendër të edukimit hyjnor ka vendosur Muhammedin s.a.v.s.. Nuk mund të edukohet ai i cili nuk e ndjek rrugën e sunnetit të Pejgamberit s.a.v.s., edhe nëse bën përpjekje për njëmijë vjet rresht. Ai as nuk mund të edukohet vet, e as të edukojë dikë tjetër.

Lidhur me këtë temë, vet Allahu Teala ka vendos një kriter hyjnor:

**“Thuaju (o Muhammed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”. 3-Imran: 31.**

Nga ky ajet kuptojmë se nuk ka rrugë tjetër për të arritur përkryerje, përveç pasimit të Pejgamberit s.a.v.s..

Pejgamberi s.a.v.s. shokëve të tij u ka mësuar islamin, imanin, dhe ihsanin, dhe i ka udhëzuar që të jetojnë në mënyrë të bukur.

Edhe shokët (as’hab) e tij, e më pas tabiinët, kanë përcjellë fenë në tërësi, pa asnjë mangësi.

## MORALI DHE RËNDËSIA E TIJ

Morali (ahlak) <sup>18</sup> i mirë është rruga e Pejgamberëve, është nga cilësitë e melaikeve, dhe ndër virtytet më të dëshiruara të Allahut Teala. Morali i mirë është dhurata më e madhe që Allahu Teala ia dhuroi robit të tij. Morali është shkak i sigurisë në këtë botë, dhe shpëtim në botën tjetër (Ahiret).

Qëllimi përfundimtar i islamit është që njerëzit të bëhen me moral të mirë, të jenë të lumtur, në këtë botë dhe në Ahiret. Edhe qëllimi i dërgimit të Muhammedit s.a.v.s. është që të kompletohet morali i mirë. Morali i mirë, në të njëjtën kohë është edhe treguesi i pjekurisë së imanit të personit.

**“Nga ana e imanit, mumini më i pjekur është ai që posedon moral të mirë dhe mirësjellje ndaj prindërve të tij.”<sup>19</sup>**

Siç u tha edhe më lartë, imani dhe morali janë të lidhur ngushtë njëri me tjetrin. Përderisa morali i mirë është tregues i pjekurisë së lartë të imanit, edhe

---

<sup>18</sup> **Ahlak [sh. Hulk]:** moral; edukatë; shprehi; veçori; natyrë; karakter; gjendje shpirtërore dhe mendore e njeriut; sjellje dhe qëndrimi moral i njeriut;

<sup>19</sup> Tirmidhiu, Rada, 11 (nr.1162); Ahmed b, Hanbel, el-Musned, 2/250; Bejhaki, Shuabu`l-Iman, nr.7981.

amoraliteti është shenjë e mangësisë në iman. Kjo për shkak se islami nuk është vetëm teori, por besimtari është i obliguar që imanin që e mban në zemër ta reflektojë edhe në veprimet e tij, në këtë rast në moralin e tij.

Për t'u kuptuar sa më mirë çështja dhe rëndësia e moralit në islam, duhet t'i referohemi edhe një hadithi të Pejgamberit s.a.v.s., i cili tri herë rresht tha:

**“Vallahi nuk ka besuar, vallahi nuk ka besuar, vallahi nuk ka besuar.”**

Atëherë shokët e tij thanë:

*“Ja Resulallah, për kë e ke fjalën?”*

Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj:

**“Ai që është i padrejtë, i keq në sjellje ndaj fqinjit.”<sup>20</sup>**

Kur është pyetur Pejgamberi s.a.v.s. për të mirën dhe të keqën, ka thënë:

**“Mirësi është morali i mirë. E keqe (gjynah) është ajo që të shqetëson nga brenda, dhe që nuk të kënaq nëse njerëzit dinë për të”<sup>21</sup>**

---

<sup>20</sup> Buhari, Edeb, 29

<sup>21</sup> Buhari, Edebu'l-Mufred, nr,295; Muslim, Birr, 5; Tirmidhi, Zuhd, 55; Bejhaki, Shuabu'l-Iman, nr. 7995.

## Shembull dhe kriter

Burimi i moralit islam janë urdhrat e fesë. Mbi të gjitha, burimi i moralit të mirë është Kur'an Kerim. Në formimin e moralit islam, bashkë me Kur'anin, burim është edhe sunneti i Muhammedit s.a.v.s.. Këto dy burime nuk mund të ndahen, siç ceket edhe në Kur'an:

**"Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit."**

68-Kalem: 4.

Tashmë është dëshmuar se është detyrim i të gjithë besimtarëve të marrin Muhammedin s.a.v.s. si model. Kjo për faktin se jeta e tij ishte pasqyrim i gjallë i Kur'anit. Kur është pyetur gruaja e Pejgamberit s.a.v.s. Ajshja r.anha., për moralin e Pejgamberit s.a.v.s., ajo ka thënë:

*"A nuk e lexoni ju Kur'anin? Morali i tij ishte Kur'ani."*<sup>22</sup>

Edhe vetë Pejgamberi s.a.v.s. thotë:

**"Unë jam dërguar që ta kompletoj moralin."**<sup>23</sup>

---

<sup>22</sup> Muslim, Musafirin, 18 (nr.139); Bejhaki, Delalu'n-Nubuvve, 1/308.

<sup>23</sup> Buhari, Edebu'l-Mufred, nr,273; Malik, Muvatta`, Husnu'l-hulk, 1 (nr.8); Ahmed b. Hanbel, el-Musned, 2/381.

Muhammedi s.a.v.s. ishte model, përfaqësues i moralit të mirë, i të mirës. Tani njerëzimi është me fat; duke shikuar nëpërmes dritares së moralit të tij, njerëzit kanë mundësi të shohin qartas të mirën dhe të vërtetën, të krahasojnë të bukurën me të shëmtuarën.

Pejgamberi s.a.v.s. erdhi në një shoqëri e cila i varroste fëmijët për së gjalli vetëm pse ishin të gjinisë femërore, popull i cili i kishte kaluar të gjithë kufijtë e amoralitetit dhe padrejtësive që i bënë njeri-tjetrit.

Ardhja e Pejgamberit s.a.v.s. me sjelljen dhe moralin më të lartë të mundshëm, bëri që ky popull ta merr shembull dhe ta pasojë atë, dhe bëri që ky popull të lë gjurmë në histori dhe të jetë i lakmueshëm.

Morali i Pejgamberit s.a.v.s. është udhërrëfyesi më i vlefshëm për të gjithë njerëzit që kërkojnë rrugën e vërtetë dhe të jetuarit e islamit në mënyrë të drejtë.

Gjeneratat të cilat jetuan me Pejgamberin s.a.v.s. pasuan rrugën e tij dhe u bënë shembull për të tjerët. Ata të cilët jetuan me Pejgamberin s.a.v.s. përfshirë burra, gra e fëmijë, u bënë dëshmitarë për moralin dhe sjelljen e tij. Enesi r.a. thotë:

*“Dhjetë vite kam qenë në shërbim të tij. Gjatë kësaj periudhe për asnjë moment nuk e kam parë atë të jetë zemëruar në mua, e lere më të më thotë ndonjë fjalë. Për punët që nuk i kryeja, asnjëherë nuk më ka pyetur pse nuk i kam bërë”.<sup>24</sup>*

---

<sup>24</sup> Buhari. Edeb. 39; Fezail, 13; Ebu Davud, Edeb, 1.

Ai është Pejgamber i mëshirës. Në luftën e Uhudit, kur Pejgamberi s.a.v.s. e theu dhëmbin e tij, përcjellësit e tij kërkuan që ai ta mallkojë kundërshtarin, e ai tha:

**“Unë nuk jam dërguar për të mallkuar. Unë jam dërguar të thërras në islam, dhe si mëshirë për mbarë njerëzimin”.**<sup>25</sup>

Duke marrë shembull Muhammedin s.a.v.s., dhe duke iu përshtatë sunnetit për çdo çështje, as’habët (radijallahu anhum) arritën përsosmërinë për një kohë shumë të shkurtër.

## MORALI I SUFIUT

Model i moralit padyshim se është Muhammedi s.a.v.s.. Prandaj është thelbësore që edhe ne të jemi të edukuar me këtë moral. Për shkak se në personalitetin e Muhammedit s.a.v.s. jo vetëm që nuk kishte cilësi shejtani, por ai ishte edhe i mbrojtur nga shejtani. Muhammedi s.a.v.s. është edukuar me rahmetin e veçantë të Allahut Teala.

---

<sup>25</sup> Muslim, Birr, 24 (nr. 87)

Ai që është në rrugë të tasavvufit, duhet të jetë i sjellshëm me njerëzit; kjo edukatë duhet të reflektojë në sjelljet e tij.

Si zemra, edhe gjuha e tij duhet të jetë e pastër. Sikurse nijeti, edhe puna duhet të jetë e drejtë; sikur brendësia, edhe pamja e jashtme duhet të jetë e pastër; sikurse në namaz, edhe në tregti duhet të jetë i përpiktë.

Ai duhet të jetë i kujdesshëm në respektin ndaj nënës, babait, familjes, fqinjëve, dhe në përgjithësi me njerëzit.

Pra, ai vepron drejtë edhe kur i bëhet padrejtësi, ai i jep atij i cili nuk i ka dhënë, viziton edhe kur nuk vizitohet, i buzëqesh edhe atij i cili nuk i buzëqesh. I përgjigjet ftesës, pranon dhe jep dhuratën. Pranon selamet dhe i jep ato, në mënyrën më të bukur. I sheh të tjerët më të mirë se veten e tij, nuk lavdërohet para tjerëve, qëndron larg nga mendjemadhësia. Sillet butë me njerëzit, është i durueshëm ndaj padrejtësive. Nuk tërbohet, e kur zemërohet e kontrollon veten e tij. Është tolerant ndaj të tjerëve; kur dikush i bën keq, ai ia kthen me të mirë.

Dashuron dhe urren vetëm për Allahun Teala. Është i sjellshëm me të gjithë dhe i mëshirshëm ndaj të gjithëve. Qëndron larg polemikave të padobishme. I

ndihmon njerëzve edhe atëherë kur vet ka nevojë për ndihmë. Është i besueshëm në amanet, e respekton mysafirin. Është i kënaqur me pasurinë e tij dhe nuk është lakmues ndaj pasurisë së fqinjit. Ai bënë dua për secilin që i bën mirë, dhe falënderon. Vazhdimisht mëson (lexon) dhe qëndron larg nga të paditurit.

Mundohet që të jetë edhe sufi edhe fakih – nuk është i kënaqur vetëm me njërën nga to. Është i vetëdijshëm që gjithmonë është në rrezik nga dëshirat e epshit, qëndron larg fitnes dhe përçarjes (fesad). Nuk gjendet në vendet e ndaluara. Asnjëherë nuk synon udhëheqjen, por nëse propozohet - udhëheq me qëllim të shërbimit në rrugën e Allahut Teala.

Mundohet që t'i kryej shërbimet ndaj njerëzve me të vetmin qëllim - arritjen e kënaqësisë së Allahut Teala.

Gjatë shërbimit, nuk e ndjen veten të privilegjuar nga të tjerët dhe asnjëherë nuk thotë *"po të mos isha unë, këtë punë askush nuk do të mund ta bënte"*, përkundrazi - ka bindjen se po të ishte dikush tjetër do ta bënte edhe më mirë.

## SI DUHET TË JETË NJË DITË E SUFIUT?

Sufiu ka model jetën dhe sjelljet e Pejgamberit s.a.v.s.. E, një ditë e zakonshme e Pejgamberit s.a.v.s. dukej kështu:

### **Namazi i sabahut**

Pejgamberi s.a.v.s., para farzit të sabahut, falte dy rekate sunnet, sunnet të cilit i kushton një rëndësi të veçantë, e në lidhje me këtë thotë:

**“Falja e dy rekateve sunnet të sabahut është më e vlefshme se gjithë bota dhe gjithë çka ka brenda saj.”<sup>26</sup>**

### **Dhikri pas namazit të sabahut**

Sufiu, mundësisht, para se të fillojë punët ditore të dynjasë, merret me mësimet e tij ditore.

Pejgamberi s.a.v.s., pas faljes së namazit të sabahut, ulej mbi sexhaden e tij dhe përmendte Allahun Teala deri në lindjen e diellit. Në lidhje me këtë, Enes bin Maliku r.a., thotë: *“ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:*

---

<sup>26</sup> Tirmidhi, Salat, nr. 416

**“Kush e fal namazin e Sabahut me xhemat dhe ulet e përmend Allahun deri në lindjen e diellit, e më pas fal edhe dy rekate sunnet, ka fituar shpërblimin e një Haxhi dhe një umreje”.<sup>27</sup>**

Më pas Pejgamberi s.a.v.s. pranonte njerëzit të cilët vinin për ta vizituar, bashkëbisedonte me ta, i këshillonte ata dhe iu përgjigjej pyetjeve të tyre.

### **Qëndrimi dhe mënyra e të folurit**

Mënyra e të folurit e Pejgamberit s.a.v.s. ishte shumë e qetë dhe e pranueshme për bashkëbiseduesin. Ishte shumë i kuptueshëm dhe shumë i qartë në të folur. Ai buzëqeshte, e asnjëherë nuk qeshte me zë. Ai kishte virtytin e njeriut më të butë dhe më të pranueshëm në botë. Edhe pse përballë me shumë padrejtësi, ishte i qetë, nuk shqetësohej fare, dhe ndaj të padrejtëve gjithherë sillej me butësi. Por kur kundërshtohej fjala e Allahut Teala, ai asnjëherë nuk heshtte, dhe jepte përgjigjen e duhur.

Pejgamberi s.a.v.s., nuk i gjykonte njerëzit nga dukja e tyre, por nga sjelljet e tyre. Gjatë gjithë kohës bisedonte me ta, i këshillonte dhe i respektonte.

---

<sup>27</sup> Tirmidhi, Salat, nr. 585

Pejgamberi s.a.v.s., ashtu siç ishte i butë dhe i mirësjellshëm ndaj shokëve dhe të afërmeve të tij, ishte i mëshirshëm edhe ndaj armikut, e në veçanti kur ata ishin të dobët. Kur dorëzoheshin, ai i falte ata dhe i ftonte me butësi në besimin e drejtë islam.

## **Namazi i duhasë**

Pejgamberi s.a.v.s., deri në kohën e namazit të duhasë, zakonisht bisedonte me shokët dhe njerëzit. Me të hyrë koha e namazit të duhasë, ngrihej dhe falte 4 ose 8 rekate. Në lidhje me vlerën dhe rëndësinë e faljes së këtij namazi Muhammedi a.s. thotë:

**“Ai që në vazhdimësi fal dy rekate namaz duhaje në ditë, i falen mëkatet edhe sikur ato të jenë sa shkuma e detit”.<sup>28</sup>**

Pas namazit të duhasë, Pejgamberi s.a.v.s., shkonte në shtëpi dhe interesohej për punët e shtëpisë.

## **Namazi i drekës**

Pejgamberi s.a.v.s., me tu ofruar koha e drekës, përgatitej për namaz. Shkonte në xhami, falte katër rekate sunnet, katër farz dhe dy të fundit sunnet. Në

---

<sup>28</sup> Ibn Maxhe, Salat, nr.1382

lidhje me faljen e sunnetit të drekës, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Ai i cili falë katër rekate sunnet para farzit dhe dy pas, Allahu ia bënë haram Xhehenemit djegien e trupit të tij”.<sup>29</sup>**

### **Pas namazit të drekës**

Pas namazit të drekës, Pejgamberi s.a.v.s. flinte - kohë e gjumit kjo që njihet si ‘kajlule’. ‘*Kajlule*’ ka kuptimin - gjumi i drekës ose pushimi. Ai i cili e praktikon kajlulen, veç fitimit të shpërblimit për aplikimin e sunnetit, merr edhe forcën e mjaftueshme për të mos ndjerë lodhje gjatë faljes së namazit të natës.<sup>30</sup>

### **Namazi i ikindisë**

Koha e kajlules përfshinë kohën pas namazit të drekës deri pak para hyrjes së kohës së ikindisë. Pejgamberi s.a.v.s., pasi që ngrihej nga gjumi i kajlules, bënte përgatitjet e nevojshme për namazin e ikindisë. Me të hyrë koha e namazit, nganjëherë e falte, e nganjëherë jo, sunnetin e ikindisë. Në lidhje me këtë sunnet, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

---

<sup>29</sup> Tirmidhiu, salat, nr, 598; Taberani, el-Mu`cemu`l-Kebir, 23/236 (nr. 456).

<sup>30</sup> Buhari, Cuma, 40; Ibn Maxhe, Savm, 22.

**“Kush i fal katër rekate sunnet, para farzit të namazit të ikindisë, Allahu ia bënë haram Xhehennemit trupin e tij”.<sup>31</sup>**

Pas faljes së namazit të ikindisë, për një kohë Pejgamberi s.a.v.s. përmendte Allahun Teala. Edhe sufiu duhet ta praktikojë këtë formë të përmendjes, sikur edhe Pejgamberi s.a.v.s..

### **Shtëpia e bekuar - Hane-i Saadet**

Pejgamberi s.a.v.s., para kohës së akshamit i vizitonte gratë e tij, rrinte me to, i pyeste për gjendjen e tyre dhe gjëra të ngjashme.

I Dërguari i Allahut Teala ishte shumë i sjellshëm ndaj grave të tij. Në lidhje me këtë, në një hadith thotë:

**“Më i miri tek Allahu Teala është ai i cili sillet mirë me gruan e tij. Unë jam më i mirësjellshmi ndaj gruas”.<sup>32</sup>**

**“Imanin më të përkryer ndër ju e ka ai që ka karakterin më të mirë dhe i cili sillet më së miri me familjen e tij”.<sup>33</sup>**

---

<sup>31</sup> Taberani, El-Mu`xhemu`l- Kebir, 23/ 281 (nr. 611).

<sup>32</sup> Ebu Davud, Sunnet, 15 (nr. 4682); Tirmidhi, Rada, 11 (nr. 1162); Ibn Maxhe, Nikah, 50.

<sup>33</sup> Tirmidhi, Iman, 6; Mundhiri, e-t-Tergib ve` t-Terhib, 3/411.

## Namazi i akshamit

Ibn Abbasi r.a. thotë:

*“Pejgamberi a.s., pas faljes së namazit të akshamit, i falte edhe dy rekate (namazi evvabin) në të cilat qëndronte gjatë”.<sup>34</sup>*

Më pas, i Dërguari i Allahut Teala ishte i zënë me ibadete nafile deri sa hynte koha e namazit të jacisë.<sup>35</sup> Edhe sufiu duhet që gjatë kësaj kohe të bëjë ibadet dhe rabita/meditim. Për shkak se koha mes akshamit dhe jacisë është e përshtatshme për rënie në harresë (gaflet), të parët tanë e kanë kaluar këtë kohë në ibadet.

## Namazi i jacisë

Me hyrjen e namazit të jacisë, i Dërguari i Allahut Teala, nganjëherë e falte e nganjëherë jo, sunnetin para farzit të jacisë. Ndërsa, asnjëherë nuk i linte pa i falë dy rekatet e sunnetit të jacisë. Më pas pushonte (flinte), dhe më vonë zgjohej për ta falë namazin e vitrit.<sup>36</sup> Nëse nuk ishte e nevojshme, Pejgamberi s.a.v.s. nuk e pëlqente të flas pas namazit të jacisë.

---

<sup>34</sup> Shiko, Hejsemi, Mexhmau`z-zevaid, 2/230

<sup>35</sup> Shiko. Hejsemi, Mecmau`z-zevaid, 2/229

<sup>36</sup> Hejsemi, Mexhmau`z-zevaid, 2/230.

## Gjumi

Pejgamberi s.a.v.s., gjatë gjithë kohës ishte me abdes, gjithashtu edhe kur binte për të fjetur. Në lidhje me këtë, Omeri r.a., thotë se Muhammedi s.a.v.s. ka thënë:

**“Kush fle me abdes, është i mbrojtur nga një melek i mëshirës. Dhe, posa të zgjohet nga gjumi meleku i lutet Allahut për faljen e tij”.<sup>37</sup>**

Ndërsa Ajshja r.anha., thotë:

*“Pejgamberi i Allahut, para se të bie në shtrat për të fjetur, ngrinte duart dhe këndonte nga tri herë Ihlas (Kulhuvallahun), Felek dhe Nas, iu frynte duarve dhe e përshkonte tërë trupin e tij, e atëherë kur ishte i sëmurë, një gjë të tillë kërkonte që t'ia bëjë unë”.<sup>38</sup>*

Pejgamberi s.a.v.s., ashtu siç u tha më lartë se me të falur të jacisë, binte për të pushuar, gjithherë binte në krahun e djathtë dhe dorën e djathtë e mbante nën kokën (faqen) e tij.

Nga gjysma e natës ose 1/3-ta e natës, zgjohej, pastronte dhëmbët me misvak, merrte abdes dhe bënte ibadet.

---

<sup>37</sup> Ibn Hibban, es-Sahih, nr. 1051.

<sup>38</sup> Buhari, Fezailu'l-Kur'an, 14, Daavat, 12; Muslim, Selam, 20; Ebu Davud, Tibb, 19 (nr. 3902); Tirmidhi, Daavet, 21.

## Namazi i natës

Ajshja r.anha., thotë:

*“Resulallahu, gjatë natës qëndronte në namaz, aq sa ju ënjtshin këmbët e tij. Një natë e pyeta atë: ‘O i Dërguar i Allahut, pse e bënë një gjë të tillë, kur ty të janë falë të gjitha mëkatet?’ Ai (Pejgamberi), më tha: ‘A nuk duhet të jem nga robërit falënderues, pikërisht për këtë arsye?’”<sup>39</sup>*

Pra, i Dërguari i Allahut Teala asnjëherë nuk e kishte lënë pa falur namazin tehexhud (namazin e natës), pikërisht për shkak se ishte vaxhib për të. Pejgamberi s.a.v.s. ka preferuar që i gjithë ummeti i tij të respektojë këto ibadete.

Pas faljes së tehexhudit, Resulallahu s.a.v.s., bënte përgatitjet për faljen e sabahut. Me të hyrë koha e namazit të sabahut, sunnetin e falte në shtëpinë e tij, ndërsa farzin në xhami.

Pra, kështu ishin në përgjithësi 24 orët e Pejgamberit s.a.v.s..

*“Muridët e vërtetë janë ata të cilët bëjnë ibadet në orët e vona të natës.”*

Gavs-i Hizani Sejjid Sibgatullah

---

<sup>39</sup> Buhari, Teheccud, 6; Muslim, Munafikin, 18; Tirmizi, Salat, 187

## RËNDËSIA E EDUKATËS

Edukata është njohja e vetes, mos-kalimi i kufirit me sjellje jo të mira ndaj tjetrit dhe mirë-sjellja ndaj shoqërisë. Edukatë janë sjelljet si të Pejgamberit s.a.v.s., mos-rënia në gabime, largimi nga punët e liga që do të na bënë në të skuqemi para të tjerëve.

Edukatë është mbrojtja e të drejtave, të dish si duhet të sillesh ndaj Hakut dhe ndaj shoqërisë. Qëllimi i vetëm i tasavvufit është mësimi i krijesës njeri në raport me sjelljet ndaj Hakut dhe shoqërisë. Kjo sepse dituria është e plotfuqishme vetëm kur shkon paralel me edukatën (dituria dhe edukata). Ai që kërkon diturinë, atë e arrin vetëm me edukatë të lartë. Dhikri, namazi, pendimi e ibadete tjera, pranohen vetëm kur bëhen me përkushtim dhe edukatë ndaj Krijuesit. Ai që nuk e arrin edukatën, nuk arrin qëllimin e tij. Prandaj miqtë e Allahut prej muridëve kërkojnë shkallë të lartë të edukatës.

Ebu Hafs thotë:

*“Tasavvufi është edukatë. Pasi çdo vend dhe çdo post ka një edukatë, edhe çdo gjendje është e përbërë nga edukata. Ata që tregojnë kujdes dhe sillen me edukatë ndaj kohës, arrijnë qëllimet e veta. Ata që janë të pa edukuar, edhe pse mendojnë se janë afër Allahut, ata janë shumë larg rrugës së Tij. Por, ka edhe të tillë që janë në shkallë më të larta të edukatës se sa që mendojnë”.*

## EDUKATA NDAJ ALLAHUT TEALA

Njeriu u krijua që ta kryej detyrën ndaj Allahut Teala. Për këtë, çdo njeri është i obliguar të besojë dhe të jetë i vetëdijshëm se Allahu Teala është Krijuesi, dhe se ai vet (njeriu), është i krijuar. Çdo njeri është i obliguar t'i nënshtrohet urdhrave dhe ndalesave të Allahut Teala. Askush nuk lirohet dhe nuk falet nga këto obligime që kërkohen nga Allahu Teala.

## PIKAT KRYESORE TË EDUKATËS SË SUFIUT

Përkushtimi i sufiut është jetësimi i urdhrave dhe ndalesave të Allahut Teala., kryerja e farzeve me rregull, gjykimi dhe veprimi me drejtësi – devotshmëri, në çdo punë. Vazhdimisht duhet t'i përshtatet sunnetit të Pejgamberit s.a.v.s. Duhet që vazhdimisht të punojë, të bëjë vepra të mira dhe ta ngrit veten në shkallë më të larta të njerëzisë. Kur të fillojë punën, duhet ta pastrojë qëllimin, në mënyrë që punën të cilën e bënë ta bëjë me dashuri. Duhet të jetë i kujdesshëm edhe gjatë shitblerjes.

Sufiu duhet ta ushqejë shpirtin e vet me dashuri ndaj Allahut Teala, Pejgamberit s.a.v.s., familjes së tij (Ehl-i bejt), shokëve të tij, ndjekësve të rrugës së tij, dijetarëve dhe njerëzve të mirë.

Duhet të ketë kujdes në fitimin e pasurisë hallal, ruajtjen nga haramet dhe gjërat e dyshimta. Vazhdimisht të mendojë në mirësitë që ia ka dhënë Allahu Teala dhe ta falënderojë Atë. Të jetë i durueshëm ndaj sprovave të Allahut Teala.

Nuk duhet ta humbë shpresën prej Allahut Teala, për asnjë moment. Edhe për më të voglin mëkat, duhet të pendohet (teube) dhe të mundohet në mospërsëritjen e tij. Të kërkojë hallallin dhe të lajë borxhet ndaj të tjerëve.

Për çdo natë të llogarisë veten e tij për veprimet ditore. Nëse llogaritja rezulton me mëkate dhe vepra të këqija, duhet të kërkojë falje nga Allahu Teala. Nëse ndodh e kundërta, duhet ta falënderojë Atë. Para se të bjerë në gjumë duhet t'ia përkujtojë vetes se çdo krijesë do ta shijojë vdekjen. Duhet ta shpenzojë gjithë jetën në rrugën e Allahut Teala.

Të merr pjesë në faljet e namazeve me xhemat dhe të jetë në safin e parë. Pas namazit të ikindisë, të bëjë hatme, në mes akshamit dhe jacisë të bëjë rabitan. Para namazit të sabahut të bëjë dhikër (përmendje), për çdo ditë ta lexojë nga një pjesë Kur'ani (xhuz). Ti mësojë rregullat e fikhut, ndërsa për gjërat të cilat nuk i kupton, respektivisht nuk i di, duhet të konsultohet me njerëzit e dijes - dijetarët. Duhet të njihet me të panjohurat dhe rregullat e tasavvufit, duhet t'i pyes njerëzit që e njohin dhe e jetojnë këtë rrugë.

Duhet ta mbajë fjalën e dhënë dhe të largohet nga fjalët e padobishme. Duhet ta dijë se ushqimi i tepërt, të folurit e tepërt dhe të fjeturit e tepërt, nuk është prej edukatës së sufiut dhe duhet të ruhet nga këto gjëra.

### KUR SUFIU RRI ME NJERËZ...

Sufiu, asnjëherë nuk duhet të merret me punët dhe të metat e të tjerëve, ai duhet të merret me të metat e tij. Për vëllezërit e tij, duhet të mendojë gjithherë mirë dhe duhet të largohet nga mendimet e këqija në përgjithësi. Kur të takohet me njerëz të cilët nuk e besojnë Allahun Teala dhe sillen në kundërshtim me të, nuk duhet të jetë i ashpër ndaj tyre, por me butësi t'ia sqarojë gjërat. Të bëjë dua për mëshirën dhe faljen e Allahut Teala ndaj atyre që bëjnë mëkate. T'i pranojë gabimet e veta. Duhet të lutet për muridët dhe gjithë myslimanët, sidomos ditën e xhuma, në muajin e Ramazanit, në Haxh, në momente kur bie shi, në mes ezanit dhe ikametit, në sexhde, dhe momente të ngjashme të favorshme për pranimin e lutjes. Kur lutet, lutet me besim dhe nënshtrim të plotë ndaj Allahut Teala; duhet të qëndrojë mes shpresës dhe frikës së Allahut Teala. Lutjen ta fillojë me falënderim ndaj Allahut Teala dhe duke i dërguar salavat Pejgamberit s.a.v.s., dhe në të njëjtën mënyrë ta përfundojë lutjen (me falënderim dhe salavat).

Kur të zgjatet dhikri (përmendja), ligjërata dhe adhurimet grupe duhet të tregojë respekt dhe durim. Duhet të jetë i durueshëm edhe ndaj të gjitha peripecive dhe sprovave të mundshme që i has në rrugë gjatë kryerjes së ibadeteve. Duhet t'i frenojë dëshirat e veta. Pavarësisht nga bindjet dhe mospërputhjet e mendimeve, sufiu duhet të ushqejë dashuri për të gjithë myslimanët e devotshëm.

Duhet të jetë i thjeshtë, modest, i butë dhe me nijet të pastër në raport me të tjerët. Duhet të jetë i kujdesshëm kur garanton për dikë (të qëndrojë prapa fjalës).

Duhet të qëndrojë larg nga njerëzit të cilët janë larg nga e vërteta. Njerëzit që janë larg të vërtetës, janë të gjithë ata që sjelljet e tyre (besimi, mendimi, edukata), bien ndesh me rregullat dhe urdhrat e Allahut Teala, pra njerëz të cilët e mendojnë vetëm këtë botë, p.sh. kur flasin, flasin vetëm për shitblerje, mendojnë vetëm paratë, pasurinë, karrierën, etj. Edhe zemra edhe gjuha e tyre janë të lidhura vetëm me problemet e kësaj bote. Atyre nuk ju intereson fare rruga e Allahut Teala dhe Pejgamberit s.a.v.s.. Këta njerëz quhen njerëz të pavëmendshëm (ehl-i gaflet) dhe në lidhje me ta dijetarët thonë: *“Kush shkon me ta, është prej tyre”*.

Sufiu nuk duhet të jetë prezent në vende ku luhen lojëra të kota dhe ku fliten gjëra të kota; nuk duhet të dëgjojë fjalët e pamoralshme boshe; duhet të

qëndrojë larg polemikave dhe lojërave të bixhozit; duhet të jetë i buzëqeshur; duhet të qëndrojë larg gjërave që i sheh syri dhe që ndikojnë negativisht në zemrën e tij. Nuk duhet ta hidhërojë askënd, nuk duhet të hidhërohet në raste të panevojshme. Nëse e hidhëron dikë, duhet të kërkojë falje nga ai dhe duhet të pendohet tek Allahu Teala, nuk duhet ta fyejë askënd, edhe nëse ka të drejtë.

Pa menduar mirë nuk duhet të marrë vendime. Nuk duhet të shikojë me përbuzje, përkundrazi – krijimet e Allahut Teala i shikon me dashuri dhe dhembshuri.

#### EDUKATA NDAJ PEJGAMBERIT S.A.V.S.

Allahu Teala e ka bërë farz (të obligueshëm) nderimin, respektin dhe përshtatjen ndaj Pejgamberit s.a.v.s. Allahu Teala nuk ka lejuar të bëhen sjellje të palakmueshme kur Pejgamberi s.a.v.s. gjendej në një mexhlis, ashtu siç nuk lejohej marrja e fjalës para tij.

As’habët e Pejgamberit s.a.v.s. e dëgjonin atë me kujdesin më të madh të mundshëm, ngase një gjë të tillë e kishte urdhëruar Allahu Teala dhe e kishin të ndaluar që dikush ta kundërshtonte apo të fliste me ton të lartë para tij.

Allahu urdhëroi ata që Pejgamberin s.a.v.s., ta thirrin me emrat më të mirë, që kur të gjenden afër tij të flasin me ton të ulët dhe për të gjitha këto sjellje të mira ndaj tij, Allahu Teala premtoi që do t'i falë dhe do të marrin shpërblime të mëdha.

Allahu Teala, urdhëroi që edhe pas kalimit të Pejgamberit s.a.v.s. në botën e pavdekshmërisë të respektohet ai.

As'habeja, nga respekti i madh që kishte për Pejgamberin s.a.v.s., nuk e gjente forcën që ta shikojë atë në sy. Kur uleshin afër tij, të gjithë e mbanin kokën ulur sikur të ishte zogu mbi kokat e tyre. Kur Pejgamberi s.a.v.s., merrte abdes, ata (as'habët) garonin njëri me tjetrin se kush do ta merr ujin e abdesit të tij. Kur binte ndonjë qime nga floku i tij, ata garonin njëri me tjetrin se kush do ta merr atë. Jepnin maksimumin për ta realizuar në praktikë çfarë thoshte ai.

Edhe muridët janë të obliguar të ushqejnë respekt ndaj Pejgamberit s.a.v.s., familjes së tij (Ehl-i bejt), dhe shokëve të tij. Gjithashtu duhet të respektohen dhe nderohen trashëgimtarët e Resulallahut s.a.v.s., të cilët janë evlia dhe murshidë të përkryer.

## EDUKATA NDAJ MURSHIDIT

Muridi duhet ta dijë se dijetarët-murshidë janë trashëgimtarë të Pejgamberit s.a.v.s., andaj mësimi dhe njohja e së vërtetës arrihet përmes këtyre murshidëve. Edhe kur është afër (murshidit) edhe kur është larg tij, muridi duhet të tregojë edukatë dhe mirësjellje ndaj tij. Të gjitha dëshirat duhet t'i lë në duart e murshidit<sup>40</sup>.

Nuk bën të shkelet vendi ku ai (murshidi) falë namazin. Në vendin ku merr ai abdes nuk duhet të merr abdes muridi. Nuk bën të shtrihen këmbët ose të pështyhet në drejtim të tij. Çka do që paraqitet nga ai (murshidi), duhet besuar se është e drejtë dhe e mirë. Nuk bën të kundërshtohet puna dhe fjalët e tij.

Sufiu, asnjëherë nuk guxon të kërkojë nga murshidi i tij mrekulli, siç është rasti i kerameteve. Madje, një gjë e tillë nuk është mirë as të mendohet. Nëse paraqitet ndonjë dyshim në zemër, menjëherë duhet informuar murshidin. Sufiu, në asnjë mënyrë nuk guxon të paragjykojë murshidin e tij.

---

<sup>40</sup> **Murshid:** Shejh; udhërrëfyes; udhëzues në rrugë të drejtë; trashëgimtari i Pejgamberit s.a.v.s.

**Kamil:** i përsosur; i përkryer.

\* Në traditën tonë, Murshidi është quajtur me emërtimin *Shejh*.

Sufiu, nuk duhet fshehur as ëndrrat e tij nga murshidi, dhe nëse është e mundur duhet t'ia shpjegojë ëndrrën atij, por nuk duhet të pritët nga murshidi shpjegimi i çdo ëndrre.

Duhet konsultuar me murshidin për ndryshimet e gjendjes shpirtërore dhe asnjëherë nuk duhet t'i besojë ëndrrave dhe gjykimit të vet, por duhet t'i besojë asaj çfarë thotë murshidi.

Gjithashtu, sufiu vazhdimisht duhet të pendohet për mëkatet e veta, në mënyrë që ta pastrojë zemrën.

Asnjëherë nuk duhet ngritur zërin para murshidit, ngase ngritja e zërit para tij është jo-edukatë.

Sufiu duhet ta dijë se çdo dituri hyjnore që vjen - shkaktar për këtë është murshidi. Edhe nëse kjo mirësi vjen nga murshidi tjetër, ai duhet ta dijë se këto kanë ardhur nga murshidi i tij.

*Bëhuni shërbëtorë, bëhuni të butë, bëhuni nga modestët, mos i keqkuptoni ata që ju kritikojnë juve, mundohuni t'i kuptoni ata; kur të vjen dikush te ju për të marrë mendimin tuaj në një çështje, mos merrni vendime pa i dëgjuar të dy palët, mos e ndjeni vetën më të ngritur se të tjerët, mos u inatosni."*

Shejh Sejjid Abdulbaki el-Husejn

## IRSHAD DHE MURSHID

Fjala irshad, ka disa kuptime: fjalë, shkrim, udhërrëfytes dhe shpjegues i së vërtetës, udhërrëfytes i rrugës së Allahut Teala, mbushja e zemrës me dashuri ndaj të vërtetës, takim i zemrës me të vërtetën, ndriçim shpirtëror, zgjim nga pavëmendja si dhe të arriturit e bërjes ibadet Allahut Teala dhe zbatimi i urdhrave të Allahut Teala.

Në tasavvuf, irshad është dashuria e robit ndaj Allahut Teala. Pra, puna e murshidëve është të shartojë zemrat me dashuri hyjnore. Kjo është trashëgimi e Pejgamberëve dhe për këtë Allahu Teala Davudit a.s. dhe Pejgamberëve tjerë iu kishte thënë:

**“Më doni Mua, doni ata që më duan Mua dhe bëni të tjerët që të më duan Mua”.<sup>41</sup>**

## TË VEÇANTAT E MURSHIDIT

Çdo murshid njëherit është evlia. Për një murshid të përkryer është e domosdoshme arritja e gradës së evliasë. Evlia ka edhe domethënien e njohjes së Allahut Teala, të jetë mik i Tij, rob i dashur dhe i afërm i Allahut Teala.

---

<sup>41</sup> Gazali, Ihjau Ulumi`d-din, 3/2322; 4/2359; Kimja-ji Saadet, f. 641.

Dijetarëve të mëdhenj dhe evliave të cilët thërrasin njerëzit në rrugë të drejtë, tregojnë Hakun dhe të vërtetën, të cilët arrijnë përkryerjen - iu thuhet murshid (shejh).

Murshidi i tregon njerëzve rrugën e drejtë. Ata japin recetën e lumturisë së kësaj bote dhe ahiretit. Ata u mësojnë pasuesve të gjitha mënyrat e ruajtjes nga mendimet dhe punët e liga, dhe me ndihmë e dua i përkrahin ata shpirtërisht.

Pra, shoqërimi dhe pasimi i murshidëve sjell mirësi dhe bereqet në personalitetin e njeriut. Pjesëmarrja nëpër ligjëratat dhe tubimet e tyre është më se e nevojshme.

## LIDHJA ME MURSHIDIN

Lidhja me murshidin varet nga gjendja e njeriut. Por, për të arritur qëllimin në pastrimin e zemrës dhe për ta fituar edukatën e sjelljeve të mira, gjithsesi duhet të krijohet lidhja me murshidin. Imam Gazali dhe një pjesë e dijetarëve një gjë të tillë (lidhjen me murshidin) e konsiderojnë obligim dhe kusht. Kjo për shkak se përveç Pejgamberëve, askush nuk është larg prej sëmundjeve shpirtërore dhe nuk mundet vet të shpëtojë prej këtyre sëmundjeve.<sup>42</sup>

---

<sup>42</sup> Ibn Axhibe, Ikazu`l-Himem, f. 21; Abdulkadir Isa, Hakaik ani`-tasavvuf f..35.

## *FILLIMISHT SHOKU I RRUGËS, MË PAS RRUGA...*

Ai i cili dëshiron të ecë në rrugën e Allahut, fillimisht duhet të gjejë shokun, pra murshidin, e më pas të bëjë lidhjen me të. Pas lidhjes me të, duhet të ecë asaj rruge ashtu siç porositet nga ai (murshidi). Kjo për shkak se kjo rrugë ka shumë peripeci, dhe pa e njohur mirë këtë rrugë dhe gjërat me të cilat mund të përballesh në të, nuk mund të arrihet kënaqësia hyjnore. Dhe pikërisht për këtë është thënë: *“fillimisht duhet shoku i rrugëtimit, e më pas marrja e rrugës”*.

Imam Gazali kishte thënë:

*“Nuk bën të marrësh rrugën pa udhërrëfyes – murshid (shejh). Për shkak se rruga është e fshehur dhe ka mundësi që të ngatërrohet rruga e shejtanit me rrugën e Hakut. Rruga e Hakut është një, ndërkas rrugët e këqija janë me mijëra. Andaj, si është e mundur që të udhëtosh në një rrugë të përzier pa një njeri i cili e di rrugën? Kur të gjendet udhërrëfyesi (murshidi), të gjitha çështjet duhet besuar atij.*

*Nëse nuk e kupton atë çfarë thotë murshidi, atëherë duhet të përkujtosh rastin e Musait a.s. dhe Hidrit a.s., ngase ky tregim është vetëm për muridin dhe murshidin.*

*Kjo për shkak se disa gjëra që thuhet nga murshidi, mendja jonë nuk arrin dot t'i kuptojë”.<sup>43</sup>*

---

<sup>43</sup> Gazali, Kimya-yi Saadet, f. 404.

## BISEDA FETARE - SOHBET

Fjala sohbet, në përgjithësi kuptohet si predikim (vaaz) dhe këshillë fetare. Por, me fjalën sohbet nënkuptohet edhe tubim i njerëzve në një vend (mexhlis), bashkim i njerëzve, thellim i njohurive, miqësi, bisedim për probleme, e kuptime të ngjashme.

Sohbeti ishte misioni, puna dhe mjeshtëria e as'habëve. Andaj, të gjithë ata të cilët morën pjesë në sohbetet e Resulallahut s.a.v.s. me qëllim të përfitimit nga nuri i shikimit të tij, ia hapën zemrat me dashuri Resulallahut s.a.v.s. duke i mbushur ato me dashuri hyjnore, quhen apo njihen me termin 'as'habe'.

## QËLLIMI I SOHBETIT

Qëllimi i sohbetit është përfitimi i kënaqësisë së Allahut Teala. Pra, sohbeti synon ringjalljen e zemrës, arritjen e diturisë së nevojshme në rrugën e pavdekshmërisë, pajisjen me moral dhe edukatë të mirë. Sohbeti më i favorshëm në tasavvuf padyshim është ai i murshidit. Andaj, nga kjo kuptojmë se sohbeti mundëson që pjesëmarrësi t'i dëgjojë fjalët e murshidit me respektin më të madh, në mënyrë që të përfitojë nga ai dhe të përfitojë nga sjellja dhe morali i tij.

Shejh Muhammed Dijauddini, i mblidhte fëmijët e vegjël dhe i mbante sohbet. Një ditë, bashkëshortja i thotë: *“I nderuar, njerëzit po çuditen me ty, ata janë të vegjël, çfarë kuptojnë nga sohbeti?”*

Dijauddini iu përgjigj:

*“Edhe unë e di që këta nuk kuptojnë nga sohbeti im, por qëllimi im nuk është ky (që ata të kuptojnë diç). Tubimet sjellin mëshirën e Allahut Teala dhe unë jam në kërkim të asaj mëshire. Këta fëmijë janë një shkak...Përfitimi nuk është nga vetë sohbeti”.*<sup>44</sup>

Sohbeti, është esenca dhe themeli i rrugës së Nakshibendive. Ashtu siç thotë edhe piri i kësaj rruge, evlia i madh, Shah-i Nakshibend:

*“Rruga e edukatës tonë është e krijuar mbi sohbetin. Mirësia arrihet vetëm me bashkim për hatër të Allahut me njerëz fetarë, të nderuar e të devotshëm.*

*Vazhdimi i sohbetit (bisedës) me ta bëhet shkak i arritjes së imanit të vërtetë.”*

---

<sup>44</sup> Abdu`l-Hekim el-Husejni, Sohbeti, f. 24.

## SOHBETI DHE EDUKATA ME MURSHID

Rruga më e sigurt për të arritur kënaqësinë e Allahut Teala është të bërit bashkë dhe prezenca në sohbetin e murshidit. Kështu që muridi duhet të jetë shumë i kujdesshëm në sjelljet e tij ndaj murshidit. Qoftë ajo lidhje shpirtërore ose kur gjendet afër tij, muridi duhet të ruhet nga sjelljet kundërshtuese. Përndryshe ndodh largimi, dhe ndërpritet rrjedhja e njohurisë.

Para se t'i del murshidit përpara, muridi duhet të bëj teube-istigfar prej zemre, dhe të jetë me një pastërti të plotë të jashtme. Para hyrjes në prani të murshidit duhet ta thotë këtë lutje: *“O Allah, më bëj nga ata që e arrijnë bereqetin e kësaj dere”*. Më pas, i vetëdijshëm, në një gjendje modestie dhe nevoje, duhet të qëndrojë para murshidit.

Njëra nga pikat kryesore është edhe kjo: As me zemër muridi nuk duhet të kundërshtojë gjendjen, fjalët dhe veprimet e murshidit, sepse kundërshtimi është shkaktar i largimit. Në qoftë se paraqitet një gjendje e tillë duhet bërë teube dhe istigfar. Kur gjendet para murshidit, në asnjë mënyrë nuk duhet të bisedojë gjëra të kota, boshe dhe biseda rreth kësaj bote. Nuk lejohet të del para murshidit, pa iu dhënë

leja. Nëse nuk e gjen murshidin në xhaminë e tij, atëherë duhet ulur me edukatë, dhe gjatë asaj kohe duhet të merret me dhikër dhe të mundohet t'i largojë të gjitha mendimet e këqija nga mendja e tij.

Një murid, në asnjë mënyrë nuk hyn te murshidi pa leje dhe nëse nuk i jepet leje duhet të thotë se inshallah do vijë prapë. Në të njëjtën kohë, muridi nuk guxon të zemërohet në raport me murshidin qoftë edhe sa grimca. Përkundrazi, duhet të besojë se këtu ka një mirësi të cilin ai nuk e di, dhe se gjithsesi do të gëzohet nga kjo.

Në rast të dhënies së lejes për të takuar murshidin, ai duhet të përgatisë veten e tij në shkallën më të lartë të mundshme të edukatës në sjellje ndaj tij. Nuk duhet të flitet pa marrë leje nga murshidi, dhe kur flet murshidi nuk duhet ndërprerë fjalën e tij. Duhet të dëgjohet me kujdes të shtuar. Nëse murshidi qorton me fjalë njërin nga të pranishmit, të tjerët duhet të thonë se *'qortimi është për mua'* dhe duhet përfituar nga kjo gjendje në përmirësimin e vetes së tyre. Gjithashtu, kur gjendet para murshidit, muridi duhet të shikojë kah gjunjët e murshidit, dhe pa qenë i detyruar nuk duhet të shikojë në anë tjera, veshjen e murshidit, apo fytyrën e tij.

Muridi, para murshidit duhet të ketë kujdes në edukatën e të folurit. Nëse murshidi e pyet diçka, ai duhet kthyer përgjigjen me një gjuhë të butë.

Kur të ndahet nga murshidi, muridi duhet pasur kujdes në mos-kthimin e shpinës, por të largohet duke ecur me hapa mbrapa. Para tij nuk duhet treguar dituri, përkundrazi, sjelljet e tij duhet të jenë sikur të nxënësve të cilët shkojnë për herë të parë në shkollë dhe nuk dinë asgjë, si dhe kjo sjellje duhet të vazhdojë gjatë gjithë kohës. Para murshidit nuk guxon në asnjë mënyrë të flet gënjeshtër, ta marr nëpër gojë dikë, apo të ankohet nga dikush.

Një murid, në asnjë mënyrë nuk i tregon masës për gjërat dhe ato çfarë i thotë murshidi atij në raste të veçanta. Ai nuk ankohet nga shejhu para të tjerëve.

Peripecia dhe synimi i çdo muridi duhet të jetë ta fitojë dashurinë e murshidit, sepse fitimi i dashurisë së murshidit është e vështirë. Por, me vullnet arrihet gjithçka. Allahu Teala ia bëftë të mundur të gjithëve, inshallah...<sup>45</sup>

---

<sup>45</sup> Shejh Ali Behxhet, Risalei Ubejdije-i fi Bejani Adabi Tarikati`n-Nakshibendije, f. 3.

*“Rruga jonë është rruga e sohbetit, ne nuk i ndalojmë as pjesëtarët e tarikateve tjera që të marrin pjesë në sohbetet tona. Vërtet çuditë me njerëzit; pse nuk marrin pjesë në sohbe, pse nuk e duan atë, pse nuk bëhen pjesë e sufive? Sepse pronari i shtëpisë së sufive është Allahu Teala, shtrirja e minderëve të tyre është Alia (kerremallahu vexhhehu), shpërndarësi i yllit të dashurisë dhe muhabetit është Hidri a.s.. Nuk ka gradë më të lartë se grada e tyre.*

*Nëse për sohbet marrin pjesë shtatë (a më shumë) persona, mund të arrihet në gradat më të larta. Për shkak se nga shtatë vetë, gjithsesi njëri është miku i Allahut Teala. Më i miri ndër të pranishmit është ai i cili për asnjë moment nuk largohet nga lidhja shpirtërore me murshidin e tij. Këtij njeriu nuk i ndalet rrjedhja e bereqetit për asnjë moment, sepse në zemrën e tij vazhdimisht rrjedh njohuri”.*

Shejh Abdurrahman-i Tahi

## MUHABBETI

Muhabbeti nënkupton, në prani dhe në mungesë (shpirtërore), përshtatje kërkesave të të dashurit, dhe kujdes nga çfarëdo kundërshtimi ndaj tij.

Në muhabbet - përkundër dashurisë dhe respektit që ndjen ndaj tij, prapë se prapë e ndjen vetën të shtrënguar dhe të frikësuar – a thua, mos rastësisht kam të meta në dashuri ndaj tij.

Kur është pyetur Xhunejd Bagdadi për muhabbetin, ka thënë:

*“Muhabbet është të largohesh nga cilësitë jo të mira dhe në vend të saj, të marrësh cilësitë e mira nga (i dashuri) njeriu që e do”.<sup>46</sup>*

Ndërkaq Mevlana Xhami thoshte:

*“Për të dashuruarin, edhe pse sheh shumë armiqësi tek i dashuri i tij, prapë se prapë miqësia është më e madhe se armiqësia. Edhe pse ndoshta ka shumë dyshime në të, prapë se prapë entuziazmi për ta forcuar dashurinë nuk mungon”.*

---

<sup>46</sup> Kusejri, Risale, f. 321; zaifi, Nesru`l-Mehasin, f. 187.

## SINQERITETI NË MUHABBET

Muridi, në muhabbetin e tij duhet të jetë i singertë, dhe këtë singeritet duhet ta ruaj, në veçanti kur gjendet pranë murshidit të tij. Zemra dhe gjuha duhet të flasin njëjtë. Kjo cilësi singeriteti ndaj murshidit duhet të jetë evidente edhe kur është në masë edhe kur është i vetëm. Dhe nëse vërtetë është i singertë, kjo do të thotë se muhabbeti i tij është i mirë. Por nëse singeriteti i tij dallon nga vendi në vend, jep të kuptohet se ai ka në muhabbet dyfytirësi dhe këputje. Ky ndryshim, vjen si pasojë e dyshimeve në fe dhe të metave të tij në rrugën e sufive. Njerëzit që kanë këto të meta nuk mund të përfitojnë hakikatin e imanit.

*“Thoni sufive le ta duan dhe ta pranojnë njëritjetrit, së bashku me të metat e tyre.”*

Shejh Sejjid Abdulbaki el-Husejin

## SI DUHET TA DUASH MURSHIDIN

Muridi, murshidin e tij duhet ta dojë më shumë se familjen, pasurinë, madje më shumë se veten e tij. Kjo dashuri ndaj murshidit, në esencë është dashuri ndaj Allahut Teala. Kjo shkallë e muhabbetit - dashurisë, në terminologjinë e tasavvufit njihet si *'fena fi'shejh'* ('humbje në muhabbetin e shejhut'). Ata që arrijnë këtë shkallë të dashurisë, dëshirë të vetme e kanë organizimin e jetës së tyre në përputhje me dëshirat e murshidit dhe atë çfarë obligohet nga ai.

Një murshid nuk ka dëshirë tjetër përpos kënaqësisë së Allahut Teala. Nënshtrimi në rrugën e tij do të thotë nënshtrim Allahut dhe Resulallahut s.a.v.s. Dhe për këtë duhet të arrihet një shkallë e lartë e sinqeritetit dhe dashuri e pastër. Vazhdimi i këtij muhabbeti në një shkallë edhe më të lartë se kjo është *'fena fi'r-resul'*, që nënkupton shkrirje në dashurinë ndaj Resulallahut s.a.v.s., dhe pasimin e rrugës së tij – sunnetit.

Në lidhje me këtë Resulallahu s.a.v.s. thotë:

**“Betohem në Allahun se nuk ka vërtet iman ai i cili nuk më do mua më shumë se familjen e tij, fëmijët e tij, nënën dhe babanë e tij, më shumë se të gjithë njerëzit tjerë”.**<sup>47</sup>

Edhe në një hadith:

**“Pasha atë, në dorën e të cilit është shpirti im, nuk ka besuar ai i cili nuk më do mua më shumë se veten e tij”.**<sup>48</sup>

Ndërkaq, shkalla me e lartë e muhabbetit është lidhja e zemrës me Allahun Teala dhe nënshtrimi i plotë Atij. Qëllimi i të gjitha ibadeteve, adhurimeve, përmendjes (dhikrit), meditimit, është arritja e dashurisë së Allahut Teala. Arritjen e kësaj gjendje dashurie të pavdekshme, dijetarët e kanë quajtur grada *‘fena fillah’*. Kjo do të thotë dorëzim i plotë Allahut Teala, kryerja me dashuri e të gjitha urdhrave të ardhura nga Allahu Teala, të dashurit e gjithë asaj çka Allahu Teala do, kjo është zhveshje nga vetja në dashuri hyjnore.

---

<sup>47</sup> Muslim, Iman, 16.

<sup>48</sup> Muslim, Iman, 16.

## IHLAS

Ihlas është dashuria e muridit ndaj murshidit të tij, cila duhet të jetë vetëm për hir të Allahut Teala.

Ihlas është sjellja me edukatë ndaj murshidit dhe të qenit në një lidhje të plotë me të. Shkalla më e ultë në lidhjen e muridit dhe murshidit, duhet të jetë në shkallën që ai (muridi) duhet ta dijë dhe besojë se çdo e mirë që vjen nëpërmjet kësaj lidhjeje dhe shkaktari kryesor është murshidi. Ai duhet ta dijë se ngritja e tij shpirtërore vjen nga murshidi i tij.

Ndërsa shkalla më e lartë e ihlasit është besimi i plotë tek murshidi - se të gjitha aktivitetet e tij duke përfshirë sjelljet, sohbetet, ligjëratat etj, bëhen vetëm për hir të Allahut Teala dhe duhet të kuptohet nga muridi se këto aktivitete të murshidit nuk janë assesi dëshira vetjake ose që kanë të bëjnë me këtë botë.

## MURIDI DHE IHLASI

Njëri ndër kushtet e edukatës së muridit, padyshim që është edhe lidhja e vazhdueshme e zemrës së tij me murshidin, dëgjueshmëri e plotë ndaj tij (murshidit) dhe bindja në atë se arritja e kënaqësive shpirtërore të tij bëhet vetëm nëpërmjet lidhjes me të. Muridi duhet ta dijë dhe besojë se Allahu Teala ka përcaktuar si mjet murshidin e tij. Edhe sikur e gjithë bota të jetë e mbushur me murshidë të tjerë, muridi duhet ta respektojë dhe ta dijë që fatin hyjnor duhet ta kërkojë pranë murshidit të tij. Sepse amaneti i muridit i është dorëzuar vetëm murshidit të tij.

Muridi, murshidin e tij e di dhe e beson si një udhërrëfyes që e udhëzon për në rrugën e drejtë. Ai beson se arritja e të vërtetës bëhet vetëm përmes murshidit të tij.

## UNË KAM VETËM NJË ZEMËR...

Muridi duhet ta shohë dhe ta ndjejë vetëm murshidin e tij ashtu siç bëri edhe Shah-i Nakshibend...

Përderisa Shah-i Nakshibend ishte duke shkuar në vizitë të murshidit të tij Sejjid Emir Kulal, tri herë i del përpara Hidri a.s., por Nakshibendi as që ndalet për t'i thënë diç atij. Më në fund Hidri a.s., prezantohet. Atëherë Shahi Nakshibend i përgjigjet:

*“Unë e di që ju jeni Hidri, por unë nuk kam as kohë e as dashuri që të ndajë me ju. Unë kam vetëm një zemër edhe atë ia kam dhënë murshidit tim Sejjid Emir Kulal. Andaj, nuk kam edhe një zemër tjetër që t'ia jap tjetër kujt. Sikur të kisha edhe një, do t'jua jepja juve”.<sup>49</sup>*

*Nëse bëhesh shkak për udhëzimin e vetëm një njeriu, jepet përfitim i njëpasnjëshëm deri te Resulallahu s.a.v.s.. Ke bërë një punë e cila është e vlefshme, më e vlefshme se gjithë pasuria e botës.”*

Shejh Sejjid Abdulbaki el-Husejin

---

<sup>49</sup> Ahmed Siddiki, Shah-i Nakshibend, f. 38; Abdulmexhid Hani, el-Hadaikul'-Verdijje, f. 127; Selahuddin b. Mubarek, Enisu't-Talibin, f. 68.

## MURSHIDI KËRKON SINGERITET

Padyshim se të gjithë njerëzit kërkojnë singeritet nga ai që e kanë përballë. Edhe Allahu Teala nga robi i tij, Pejgamberi s.a.v.s. nga Ummeti (populli) i tij, dhe murshidi nga muridi i tij, kërkojnë singeritet.

Në fenë islame, për shkak që zemra merret si esencë, të gjitha përfundimet marrin formën e vërtetë në bazë të nijetit (qëllimit) dhe singeritetit në zemër.

Për ta kuptuar këtë më mirë, e kemi hadithin e Resulallahut s.a.v.s.. Ibn Omeri r.a., tregon:

*“Përderisa isha me Resulallahun s.a.v.s. dhe erdhi Harmele b. Zejd el-Ensari r.a., nga bijtë e Harises. U ul para Resulallahut s.a.v.s. dhe në gjuhën e tij, duke bërë shenjë me dorë tha:*

*“O Resulallah! Imani është në gjuhën time, por në zemër kam përçarje. Zemra ime shumë pak po e përmend Allahun Teala.”*

Resulallahu s.a.v.s., heshti dhe nuk tha asgjë. Harmele r.a., e përsëriti prapë dhe Resulallahu s.a.v.s. e kapi për majë të gjuhës Harmelin dhe bëri dua duke thënë:

**“Allahu im! Jepi këtij njeriu një gjuhë që flet të drejtën dhe një zemër që falënderon. Dhuroji dashurinë time dhe dashurinë që të tjerët ndjejnë për mua. Bëja përfundimin e mirë.”**

Harmelevazhdoi duke thënë:

*“O Resulallah! Unë kam vëllezër, por ata janë mynafik. Thonë se janë besimtarë, por brendësia e tyre nuk e thotë një gjë të tillë. Unë jam prijësi i tyre. A t’ju them të vijnë tek ju?”*

Resulallahu s.a.v.s. iu përgjigj:

**“Kush vjen, dhe me singeritet sqaron gjendjen e tij, siç erdhe ti, ne lutemi tek Allahu Teala për të. Kush vazhdon në gjynahe, përgjigjen e merituar e merr nga Allahu Teala - ne nuk përpiqemi që të zbulojmë gjynahet e askujt”.<sup>50</sup>**

## DORËZIMI

Dorëzimi arrihet atëherë kur muridi nuk e kundërshton as me gjuhë e as me zemër murshidin e tij. Muridi, në rrugën e Allahut Teala duhet të jetë i lidhur tërësisht me murshidin e tij, që nënkupton se çdo sferë e jetës së tij duhet të jetë në përputhshmëri me atë çfarë thotë murshidi. Urdhrat, kërkesat, rekomandimet që vijnë nga murshidi, duhet t’i pranojë pa kurrfarë dyshimi dhe duhet të besojë se të gjitha këto janë për të mirën e tij. Muridi duhet t’i dorëzohet murshidit të tij, ashtu siç i dorëzohet i vdekuri larësit të tij.

---

<sup>50</sup> Teberani, el-Mu`xhemu`l Kebir, no. 3475; Hejsemi, Mexhmau`z-Zevaid, nr. 16147; Ali el-Muttaki, Kenzu`l-Ummal, nr. 10445.

*Një ditë, Shah-i Nakshibendi shkoi në teqe për të dëgjuar sohbetin e murshidit të tij Sejjid Emir Kulal. Murshidi ishte duke biseduar me muridët e tjerë. E shikoi atë me një shikim përkëdhelës dhe urdhëroi që të largohet nga aty. Muridët e nxorën jashtë Shah-i Nakshibendin. Ishte stinë dimri. Koha ishte mjaft e ftohtë dhe binte borë. Edhe pse e larguan nga brenda, Shah-i Nakshibend nuk u largua prej teqesë por vendosi që të bëjë luftë me nefsin (veten) e tij. E vendosi kokën në pragun e teqesë edhe pse mbi trupin e tij binte borë. Kështu mbeti deri ne mëngjes dhe brenda kësaj kohe trupin ia kishte mbuluar bora.*

*Emir Kulale, duke dalë jashtë për namazin e sabahut, dhe me të parë gjendjen e muridit e tij, (Shah-i Nakshibendit) e mori dhe e futi brenda duke i nxjerr gjembat nga këmbët e tij dhe duke i futur këmbët e Shah-i Nakshibendit në prehrin e tij për ti ngrohur ato. Atëherë, ia veshi atij rrobat e lumturisë.<sup>51</sup>*

---

<sup>51</sup> Ahmed Siddiki, Shah-i Nakshibend, f. 31; Nexhmeddin Erbili, Hulasatu'l-mevahib, f. 54; Abdulmexhid Hani, el-hadaiku'l-verdijje, f. 126.

Një ditë, Shah-i Nakshibend kishte dalë me muridët e tij jashtë qytetit. Derisa kalonin rreth një lumi i cili nga të reshurat e mëdha të shiut merrte me vete çdo gjë, madje shkulte edhe lisat, Shah-i Nakshibendi iu drejtua Alaeddinit dhe i tha:

*“Hyn në lumin e tërbuar”.*

Me të hyrë në ujë, Alaaddinin e mori lumi. Muridët e tjerë, edhe pse ishin të habitur nga kërkesa e murshidit, nga respekti dhe edukata që kishin, nuk e pyetën për urtësinë e kësaj gjëje. Shah-i Nakshibend me muridët vazhduan rrugën, një kohë shëtitën në fushë të hapur dhe në mbrëmje po kalonin nga lumi i cili e përpiu Alaaddinin. Shah-i Nakshibend i pyeti muridët: *“Sa vetë ishim ne? Kemi ndonjë mangut?”*

Ata i thanë se një mungon, se ai në mëngjes kishte hyrë në lum mu në këtë vend, dhe e kishte marrë lumi.

Shah-i Nakshibend, i zgjati duart drejt lumit dhe tha: *“Eja Alaeddin.”*

Alaeddini doli nga lumi me rroba të thata. Atëherë Shah-i Nakshibend iu drejtua muridëve me këto fjalë:

*“E shihni! Lumi i mori të gjithë lisat të cilët kishin rrënjë të dobëta. Por për shkak që rrënjët e Alaeddinit ishin të forta, atë lumi nuk mundi ta rrëmbej.”*

## RABITA

Fjala rabita ka kuptimin e lidhjes së dy gjërave mes vete. Në të njëjtën kohë, me këtë fjalë nënkuptohet edhe fija që lidhë dy gjëra, si edhe pikat e përbashkëta të dy njerëzve, siç janë dashuria, interesi etj.

Ndërsa në terminologjinë e tasavvufit, rabita ka kuptimin e lidhjes së zemrës së muridit me zemrën e murshidit.

Kjo zemër është e formuar me dashuri hyjnore dhe me përmendje (dhikër). Edhe zemrat tjera që lidhen me këtë zemër e marrin fatin e dashurisë hyjnore dhe përmendjes (dhikrit), ushqehen, forcohen dhe rindërtohen.

## URDHRI I FESË

Në fe, rabita është një formë e meditimit. Meditimi është të menduarit e ekzistimit të mëshirës hyjnore në krijesa dhe ngjarje, perceptimi i urtësisë dhe fuqisë që kjo ekzistencë ka, dhe kjo të jetë shkak që zemra të kalojë në gjendje të përmendjes (dhikrit). Meditimi është i obligueshëm, dhe në Kur'an në disa vende është i urdhëruar. Ajshja r. Anha., tregon:

*“Pejgamberi s.a.v.s. falte namaz dhe qante. Pas namazit e pyeta Pejgamberin s.a.v.s: ‘Pse qan? Dihet se Allahu Teala të ka falur gjynahet e kaluara dhe të ardhurat.’ E ai tha:*

*“Si mos të qaj përderisa më ka zbritur ky ajet”:*

**“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendimtarët.”** 3-Ali Imran: 190.

...dhe vazhdoi duke thënë:

**“Sa keq për atë i cili e lexon këtë ajet e nuk mediton”.<sup>52</sup>**

---

<sup>52</sup> Ibn Hibban, Es-Sahih, nr. 620; Sujuti, ed-Durru`l-Mensur, 2/409.

## NJË VEÇORI QË I PËRKET NJERIUT

Bërja e rabbitës është një veçori që i përket njeriut. Ai që ka zemër dhe shpirt, padyshim që e bën një lloj të rabbitës. Edhe fusha e të menduarit është e pakufizuar. Por, çdo lloj i rabbitës nuk e inicion zemrën për adhurim dhe nuk e përgatit atë për ahiret. Lidhja e zemrës me gjëra të ndaluara, ushqimi i dashurisë për to, meditimi dhe mendimi për to, padyshim nuk është e lejuar dhe është gjynah.

Nga kjo kuptojmë se besimtari duhet ta dijë dhe mendojë mirë se çfarë mendon dhe me çfarë e lidh zemrën e tij.

*“Bëhuni të butë dhe modest; Ndaj kritikuesve silluni butë, mundohuni që ti kuptoni ata. Por nëse (kritikuesi) bëhet zbatues i edukatës, nuk duhet humbur shpresat nga ndihma e evliave.”*

Shejh Sejjid Abdulbaki el-Husejin

## DHIKRI

Fjala dhikër ka kuptimin: "përkujtim, përmendje, zgjimi i zemrës nga pavëmendja (gaflet), falje namazi dhe bërje e duasë". Ndërkaq në fjalorin e sufive ka kuptimin e të përkujtuarit dhe të përmendurit e Allahut me emra të caktuar.

Dhikri (përmendja) është një amanet dhe fshehtësi të cilin Allahu Teala e vuri në zemrat tona. Lum ata që arrijnë këtë fshehtësi dhe që e ruajnë këtë amanet...

Në Kur'an dhe sunnet, janë përmendur lloje të ndryshme të dhikrit. Pejgamberi s.a.v.s., i praktikonte të gjitha llojet e dhikrit. Ai dhikrin e bënte kur ishte i vetëm dhe kur ishte me xhemat; edhe dhikrin në fshehtësi edhe atë të hapur.

Pejgamberi s.a.v.s., disa as'habëve iu kishte mësuar dhe preferuar bërjen e dhikrit në fshehtësi e disave atë të hapur, varësisht nga natyra/karakteri i tyre. Por, gjithashtu kishte përcaktuar lloje të dhikrit që duhet të bëhen nga të gjithë.

Dhikri mund të bëhet në çdo kohë dhe në çdo vend. Pra, përderisa për ibadetet tjera ka kohë dhe vende të caktuara, për dhikrin nuk ka ndonjë kufizim të tillë. Dhikri nuk bëhet vetëm me gojë, ajo bëhet edhe me zemër.

Përmendja e vazhdueshme quhet *‘dhikr-i mutlak’*. Ky lloj i përmendjes bëhet në çdo vend dhe kohë dhe qëllimi i bërjes së tij është afrimi tek mëshira e Allahut Teala. Ibn Abbasi r.a., thotë:

*“Allahu, për besimtarin ka përcaktuar një kohë për bërjen e ibadeteve farz. Pengesat që e pengojnë njeriun për realizimin e këtyre ibadeteve, Allahu i ka arsyetuar. Allahu Teala nuk ka përcaktuar sasi ose kohë për përmendjen. Por, Ai ka urdhëruar:*

**“O ju që besuat! Përmendni shumë Allahun, kur jeni në këmbë, ulur dhe të shtrirë.”**

3-Ali Imran: 191.

Për mos-përmendje nuk pranohet arsyetim, përpos kur robi është i çmendur. Nëse meditojmë rreth ajetit të cituar më lartë kuptojmë urdhrin e Allahut Teala kështu:

*“O ju besimtarë, përmendni Allahun, ditën dhe natën, kur jeni në rrugë dhe në det, kur jeni në rrugëtim dhe në shtëpi, kur jeni të pasur dhe në varfëri, kur jeni të shëndoshë dhe të sëmurë, fshehurazi dhe haptazi. Bëni tesbih në mëngjes dhe*

*mbrëmje. Nëse e praktikoni këtë, Allahu Teala lëshon mëshirë mbi juve dhe melekët bëjnë istigfar për ju*.<sup>53</sup>

Allahu Teala i lavdëron ata që bëjnë përmendje (dhikër) vazhdimisht duke thënë:

**“Ata lartësojnë (Allahun) natë e ditë dhe nuk mërzen.”** 21-Enbija: 20.

**“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zekatin, ata i frikësohen asaj dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.”** 24-Nur: 37.

Rreth komentimit të këtij ajeti Allame Alusi (rahmetullahi alejh) thotë:

*“Shumë nga tarikatet, e sidomos të mëdhenjtë e tarikatit Nakshibendi, kanë arritur gjendjen e dhikrit të përhershëm, të përmendur në këtë ajet, e këtë ia kanë vënë vetes si qëllimin më të madh. Ky dhikër është vendosur në zemrat e tyre aq fuqishëm, sa që në asnjë moment nuk kanë qenë të pakujdesshëm (gafil) ndaj përmendjes së Allahut Teala.”*<sup>54</sup>

---

<sup>53</sup> Gazali, ihjau Ulumi`d-Din, 1/535; Abdulkadir Isa, Hakaik ani`-t-Tasavvuf, f. 121.

<sup>54</sup> Alusi, Ruhu`l-Meani, 9/378 (Bejrut-1994).

*“Dhikri është ushqimi i zemrës. Ajo zemër e cila nuk e merr ushqimin e mjaftueshëm dobësohet e më pas vdes. Zemra vetëm me dhikër ushqehet, forcohet dhe ëmbëlsohet. Në dhikër, zemra gjen jetë. Ndërsa haramet dhe gjynahet janë ushqim i shejtanit.*

*Bërja e gjynaheve dobëson zemrën e njeriut dhe forcon armikun e tij - nefsin dhe shejtanin. Për këtë arsye, zemra në njërën anë, dhe nefsi e shejtani në anën tjetër, janë në luftë të vazhdueshme përbrenda njeriut. Allahu Teala thotë:*

**“Pra ta dini se me të përmendur Allahun (dhikrillah), zemrat qetësohen.” (13-Ra’d: 28)**

Sejjid Abduhakim el-Husejn

## FLAMURI I VELAJETIT (EVLIJALLËKUT)

Për të arritur fitoren, rruga e vetme është dhikri. Edhe Kur'ani edhe sunneti, si derë të shpëtimit kanë treguar përmendjen. Përmendja është çelësi i gjitha dyerve të mirësisë. Përmendja është flamuri i velajetit. Nuk është e mundur të paramendohet miqësia me Allahun Teala pa dhikër. Ebu Seid el-Harraz thotë:

*“Kur Allahu dëshiron ta merr në miqësinë e Tij robin, ia hap atij derën e dhikrit. Pas hapjes së kësaj dere, ia hap derën e afërsisë ndaj Tij. Pastaj e merr në mexhlin e miqësisë së Tij. Më pas e ul në karrigen e tevhidit (njëshmërisë) dhe e ngrit perden e madhështisë. Kur syri e sheh madhështinë hiqet edhe vullneti i lirë (xhuz-i irade). Kur realizohet kjo gjendje, robi kalon përtej vetes së tij, dhe hyn në mbrojtjen e Allahut Teala. Robi qëndron larg kënaqësive të nefsit të vet dhe shpëton prej ligësive të tij.”<sup>55</sup>*

Ndërsa Ebu Ali ed-Dekkak thoshte:

*“Dhikri është flamuri i velajetit. Kushdo që është i suksesshëm në dhikër i jepet ky flamur. Kurse atyre që nuk bëjnë vazhdimisht dhikër, iu merret ky privilegj.”<sup>56</sup>*

---

<sup>55</sup> Harraz, Kitabu`s-Sidk, f. 5. Kusejri, Risale, f.263.

<sup>56</sup> Kusejri, Risale, f.221; Yafii, Neshru`l-Mehasin, f. 85, 246.

## LEJA DHE NDJEKJA E MURSHIDIT NË DHIKËR

Pastrimi i zemrës bëhet me dhikër. E dhikri duhet të mësohet nga një murshid dhe të merret leje nga ai, ngase dhikri i cili bëhet pa leje, mund të bëhet shkak i mos-arritjes së qëllimit.

Gjithsesi, njeriu mund të bëjë dhikër edhe vetë, patjetër që ka shpërblime, por, në bërjen e dhikrit pa kontrollin dhe lejen e murshidit, mund të ndërhyjë shejtani dhe personi ta pëlqejë veten e tij, gjë që bëhet shkak i mendjemadhësisë.

Dhikri që bëhet nën kontrollin e murshidit, mundëson përcjelljen e tij gjatë kalimit të etapave, ndërsa ndryshimet e mundshme në brendësi dhe në trupin e atij që bën dhikrin janë nën kontrollin e murshidit.

## MËSIMI I HAKIKATIT NGA KOMPETENTI

Haxhe Abdulhalik Gyxdyvani në rini merrte mësim tefsiri nga hoxha i tij, Shejh Sadreddini. Kur mbërrijtën në ajetin:

**“Lutni Rabbin tuaj të përulur e në heshtje, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.” (7:55)**

Guxhduvani e pyeti hoxhën:

*“Efendi! Si bëhet duaja dhe dhikri i fshehtë që përmend ky ajet? Kur dikush bën dua dhe dhikër haptas, njerëzit e dëgjojnë dhe shohin. Por, shejtani e dallon edhe nëse je duke bërë dhikër në vete. Sepse në hadith thuhet:*

**“Shejtani qarkullon brenda njeriut ashtu si qarkullon gjaku në damarë.”<sup>57</sup>**

*Si i bëhet dhikër fshehtas, e të mos u shfaqesh as njerëzve e as shejtanëve?”*

Hoxha i tij pranoi me habi pyetjen dhe tha:

*“O biri im! Ajo është dituri hyjnore (ilmi ledun). Në qoftë se Allahu Teala dëshiron, të takon me ndonjërin nga miqtë e Tij, e ai ta mëson këtë dhikër të fshehtë.”*

Abdulhalik Guxhduvani filloi ta pres atë mik. Në fund të pritjes, Allahu Teala e takoi fillimisht me Hidrin a.s., e më pas edhe me arifin e madh Jusuf Hemadanin.

Hidri a.s., ia mësoi Guxhduvanit me rrugë të fshehtë dhikrin *nefj-u isbat*: ‘*la ilahe illallah*’. Ndërsa Jusuf Hemadani punoi në edukimin e tij shpirtëror. Në fund, atë e ngritën të merret me *irshad* të njerëzve.<sup>58</sup>

---

<sup>57</sup> Buhari, Ahkam, 21; Ebu Davud, Savm, 78; Ibnu Maxhe, Sijam, 65; Darimi, Rikak, 66; Ahmed, Musned, III, 156, 285.

<sup>58</sup> Erbili, el-Mevahibul`l-Sermedijje, f. 95; Ahmed Siddiki, Shah-i Nakshibend, f. 72; Mevlana Safi, Resehat. f. 25.

*“Përmbajuni me përpikmëri sheriatit. Mos veproni me emocion.*

*Shumica e sufive mund të mos e shohin  
hizmetin e një sufiu tjetër. Mundin e tij le ta dijë vetëm  
Allahu Teala.*

*Për asnjë moment mos t`ju lëkundin fjalët e të  
tjerëve. Do të ballafaqoheni me shumë vështirësi,  
grykime dhe kundërshtime të ndryshme. Atë që e bëni,  
bëjeni për hir të Allahut Teala dhe dashurinë e Tij.  
Shpërblimin ua jep Allahu Teala, bëhuni të logjikshëm  
dhe të durueshëm. Gjithnjë konsultohuni dhe vendosni  
bashkë për gjërat e rëndësishme.”*

Shejh Sejjid Abdulbaki el-Husejni

## ÇKA DO TË THOTË VIRDI?

Vird është praktikimi i mësimi dhe përmendjes (dhikri) në vazhdimësi. Virdi është ilaçi ditor i zemrës. Për ta zgjuar zemrën nga gafleti dhe për t'i gjetur shërim, atë duhet ushqyer çdo ditë me këtë ilaç. Kur dhe sa duhet përdorur ilaçin, e përcakton murshidi, që është mjeku shpirtëror. Ndërsa i sëmuri duhet të përdorë ilaçin sipas recetës që merr nga murshidi.

## VAZHDIMËSIA E DHIKRIT ËSHTË KUSHT

Edhe në dhikër, si në ibadetet tjera, kërkohet vazhdimësia. Në lidhje me këtë në Kur'anin famëlartë thuhet:

**“Dhe adhuroje ti Rabbin tënd, deri sa të të vij ty e vërteta (vdekja).”** 15-Hixhr :99.

Pejgamberi s.a.v.s. dhe shokët e tij, ishin të vazhdueshëm në veprat dhe ibadetet e tyre deri në vdekje. Pejgamberi s.a.v.s. thotë:

**“Puna më e pëlqyer tek Allahu është vazhdimësia në vepër.”** <sup>59</sup>

---

<sup>59</sup> Buhari, Iman, 16, Ezan, 81, Rikak, 18; Muslim, Musafirin, 30 (nr. 215).

Nuk duhet harruar se virdi është ilaç për zemrën, dhe se për tu shëruar zemra e sëmurë, duhet marrë çdo ditë këtë lloj ilaçi.

Nëse virdi merret pa kontrollin e murshidit, ekziston mundësia që ky ilaç të shkaktojë çrregullime në zemër.

Për këtë shkak muridi duhet të konsultohet me murshidin e tij, për ta verifikuar gjendjen e tij. Murshidi, pas kontrollimit të gjendjes, tregon si të vazhdohet me virdin. Ndërsa, nëse zemra e praktikuesit të virdit nuk është më mirë se një ditë më parë, konsiderohet që ajo ka hasur në çrregullime.

Edhe Pejgamberi s.a.v.s., na ka porositur në hadithet e tij, se ditët e myslimanit nuk duhet të jenë të njëjta, përndryshe te ai ka çrregullime.<sup>60</sup>

---

<sup>60</sup> Dejlami, Firdevsu'l-Ahbar, nr. 6323; Axhluni, Keshfu'l-Hafa, nr. 2404; Sehavi, el-Makasidu'l-Hasene, nr.1078.

## VLERAT E LARTA TË HATM-I HAXHEGAN

Haxhegan ka kuptimin hoxhallarë, dijetarë të mëdhenj. Ndërsa me Hatm-i Haxhegan, nënkuptohet forma e hatmes së praktikuar nga ana e këtyre hoxhallarëve dhe të dashurve të Allahut.

Arsyeja që ky lloj i dhikrit quhet *hatme* është për shkakun se murshidët dhe muridët në mexhlise e përfundonin tubimin e tyre me këtë lloj dhikri.

Ndërsa, gjithashtu shkak është se në këtë dhikër këndohet (lexohet) Fatiha dhe surja Ihlas, me qëllim të arritjes së vlerës së këndimit të një hatmeje.

Pejgamberi s.a.v.s. na ka paralajmëruar se kush e këndon 3 herë suren Ihlas, ka arritur sevapin e një hatmeje të Kur'anit.<sup>61</sup> Ndërsa në hatmet e mëdha këndohet 1000 herë surja Ihlas. Dhe kjo ka sevapin e të bërit Kur'anin hatme tridhjetë e tri herë (33).

Hatm-i Haxhegan ishte me shumë vlerë për dijetarët Nakshibendi dhe të parët i kishin dhënë shumë rëndësi praktikimit të saj. Me përjashtim të ndonjë sëmundjeje ose udhëtimi të gjatë, përndryshe ky lloj dhikri ishte praktikuar vazhdimisht gjatë gjithë jetës.

Ky lloj i hatmes bëhet edhe individualisht edhe në grup. Është i inkurajuar edhe me sunnet dhe Kur'an. Në Kur'an është thënë:

---

<sup>61</sup> Muslim, Salatu`l-Musafirin, 261; Tirmizi, Fezailu`l-Kur'an

**“Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Rabbin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij, dhe mos hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, se puna e tij ka mbaruar.” 18-Kehf: 28.**

Të parët, ndjekjen e kësaj rruge e kishin parë si mjet për të arritur kënaqësinë e Allahut Teala dhe pas praktikimit të saj, i kishin mësuar edhe muridët e tyre.

Dijetarët e nderuar kanë treguar se Hatm-i Haxhegan është shkak i pranimit të duave nga ana e Allahut Teala, mbrojtja nga belatë e mundshme.

Në të njëjtën kohë, praktikimi i kësaj përmendjeje sipas mënyrës së të parëve, muridëve iu sjell shumë dobi shpirtërore.

CILA PUNË...

Një ditë e pyetën Gavs Sejjid Abduhakim el-Husejnin:

*“I nderuar, ne po bëjmë hatme, edhe të parët tanë i dhanë shumë rëndësi kësaj. A thua çfarë janë përfitimet e këndimit të hatmes?”*

Gavsi u përgjigj kështu:

*“Përfitimet e hatmes janë të shumta. Sikur tani më thotë Resulallahu s.a.v.s.:*

**“Punën më të mirë dhe më të rëndësishme ia preferoj ummetit tim”, a e dini ju se cilën punë do të ju thosha ta punonin? Hatm-i Haxheganin.**

*Për shkak se prijësi i kësaj Hatmeje është Resulallahu s.a.v.s.. Me të filluar të këndimit të silsile-i sherifit, zbret ruhanijeti i Resulallahut s.a.v.s. dhe ruhanijeti i të gjithë sadatëve, të cilët i regjistrojnë dëshirat e xhematit.*

*Me të përfunduar të leximit të silsiles, ruhanijeti i Resulallahut dhe të gjithë sadatëve ia paraqesin Allahut Teala kërkesat dhe dëshirat e xhematit. Asnjëherë nuk refuzohet kërkesa e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.”*

*“Hizmeti duhet të jetë nga vetë shpirti. Ndërsa qëllimi duhet të jetë hizmet ummetit të Muhammedit s.a.v.s.*

*Do të vrapojmë, nëse lodhemi, ia dorëzojmë tjetrit. Por gjithsesi duhet të jemi të singertë. Vazhdimisht ta përtërijmë dashurinë ndaj hizmetit.*

*Kush dëshiron të bëjë hizmet ashtu siç kërkuan të parët, duhet të tregojë modesti dhe butësi. Nuk duhet të shkelë mbi shpinën e sufive.*

*Ata që bëjnë hizmet për përfitime personale e që shtiren kinse po e bëjnë në rrugën e Allahut, kanë përgatitur vendin e tyre në xhehenem.”*

Shejh Sejjid Abdulbaki el-Husejni

## VLERA E LARTË E HIZMETIT

Themeli i moralit të islamit është të drejtuarit Allahut Teala me singeritet dhe dashuri. Shenja më e rëndësishme e këtij drejtimi kah Ai është hizmeti (shërbimi) robërve të tij. *‘Hizmeti – është begati (nimet)’*.

Pejgamberët dhe gjithë të dashurit e Allahut Teala e kanë arritur kënaqësinë e Allahut duke bërë hizmet, sepse hizmeti është shkalla më e lartë e devotshmërisë dhe është shkak për të arritur shpërblim të përjetshëm. Pejgamberi s.a.v.s., thotë:

**“Zotëria i një populli është ai i cili i bën hizmet atij populli.”<sup>62</sup>**

Hizmet është të jesh i dobishëm për njerëzit - me dituri, pasuri dhe sakrificë, të ndihmosh ata që kanë nevojë, të jesh bamirës për të gjithë.

Hizmeti është pasqyra e besimtarit, peshore e besimit të tij. Muridi sakrifikon çdo gjë për Allahun. Muridi është sikur dheu që përbinë dhe pastron pisllekun që hedhet mbi të, e pastaj nga kjo nxjerr lule. Sido që të sillen njerëzit me muridin, prej tij del vetëm mirësi dhe dobi.

---

<sup>62</sup> Dejlemi, Firdevsul'l-Ahbar, nr. 3291; Sujuti, es-Xhamiu`s-Saghir, nr. 4751; Axhluni, Keshfu'l-Hafa, 1/409 (nr.1513).

Muridi nuk guxon të kufizojë hizmetin vetëm për për shoqërinë dhe popullin e vet. Hizmet i bëhet të gjitha krijesave. Sikur besimtari, edhe jo-besimtari ka nevojë për hizmet, dhe meriton interesim. Duhet tentuar që me kujdes dhe logjikë të bindet jo-besimtari në bukurinë e Islamit, edhe kjo është hizmet.

Hizmet është edhe të ftohet një gjynahqar në pendim (teube), t'i mësohet të paditurit (xhahil) ajo çka ai nuk e di, të përkujtohet i padrejti në padrejtësitë e veta, i pavëmendshmi (gafili) të dashurohet në dhikrin e Allahut

Hizmeti bëhet shkak i përfitimit dhe ngritjes shpirtërore.

## EDUKATA NË HIZMET

Edukata në hizmet është më e rëndësishme se vetë hizmeti. Të gjitha punët e mira arrihen vetëm me edukatë dhe sinqeritet të pastër. Të gjitha punët zbukurohen me edukatë dhe marrin vlerën me sinqeritet. Për këtë, çdo njeri hizmetin duhet ta dijë si mirësi nga ana e Allahut Teala.

Asnjë hizmet nuk duhet të shihet si i pa vlerë dhe i vogël. Ngase, një hizmet që në shikim të parë duket i vogël dhe i pavlerë, tek Allahu mund të ketë vlerë shumë të madhe.

Në lidhje me këtë Ebu Abdullah Rugandi thotë:

*“Keni kujdes, asnjëherë mos zgjidhni në mes hizmeteve që ju jepen, asnjë hizmet mos e shihni të vogël (të pavlerë). Ngase, hizmeti nuk ndahet në të madh e të vogël.*

*Një shërbim (hizmet) që në syrin tuaj duket i vogël, tek Allahu mund të jetë shumë i vlefshëm. Fshehtësitë e Allahut Teala nuk dihen! Gjithashtu nuk dihet se në cilin hizmet është kënaqësia e Tij.*

*Prandaj, për të arritur kënaqësinë e Allahut - vazhdoni në shërbim. Të gjithë ata që bëjnë hizmet në rrugën e Allahut, padyshim se përfitojnë nga ai hizmet. Allahu ua shtoftë të mirat atyre.”*

## RREZIKU MË I MADH NË HIZMET

Rreziku më i madh i hizmeqarit vjen atëherë kur e vëren se ka arritur suksesin në hizmet. Andaj, ai i cili e arrin suksesin në hizmetin e tij, duhet ta pret këtë me modesti dhe ta dijë se nuk është i vetmi dhe i dalluari i njerëzimit. Përkundrazi, duhet të lutet tek Allahu që ta ruaj nga mendjemadhësia që do të jetë shkak i pengesës për të bërë hizmete edhe më të mëdha se kjo. Dhe assesi nuk duhet të thotë dhe të mendojë: *‘këtë hizmet vetëm unë mund ta bëj’* ose *‘askush nuk mund ta bëjë këtë më mirë se unë’*. Ngase vetëm Allahu Teala është Ai i cili nuk ka nevojë për askënd.

Shejh Sejjid Abdulbaki el-Husejin thotë:

*“Hizmeti është nimet i Allahut për njeriun.”*

Ndërsa në cilin hizmet ka mirësi/bekim (nimet) më së miri e ka sqaruar Shejh Ali Ramiteni:

*“Ka shumë njerëz që bëjnë hizmet. Por, janë të paktë ata që e dinë hizmetin si nimet të Allahut. Të gjithë ju që u është dhënë mundësia e të bërit hizmet dhe e dini hizmetin si nimet - të tjerët janë të kënaqur me ju dhe janë të paktë ata që ankohen nga ju...”*

E, Imam Kushejri kishte thënë:

*“Muridi i cili është i zënë me hizmet, kur është në shoqëri të dervishëve, asnjëherë nuk duhet të dal*

*karshi tyre, përkundrazi duhet të dal karshi nefsit të tij, nëse nefs i është kundër tyre. Duhet ta dish se të gjithë dervishëve mund t'ju kesh borxh, por asnjëri nga ta nuk të ka borxh ty.”<sup>63</sup>*

Shejh Haxhe Ubejdullah Ahrari thotë:

*“Ne këtë rrugë nuk e fituam nga librat e Tasavvufit, por nga hizmeti që i bëmë njerëzve. Të mëdhenjtë e kësaj rruge çdo murid e sjellin tek e vërteta e Allahut me një shkak (hizmet). Hizmeti na solli në këtë shkallë.”<sup>64</sup>*

*“Praktikuesit dhe pasuesit e rrugës Nakshibendi veprojnë sipas nevojës së kohës në të cilën jetojnë. Një hizmet që bëhet shkak për ta fituar një zemër, vjen para përmendjes (dhikrit). Disa mendojnë se ibadetet nafie janë më të vlefshme se hizmeti. Por, mirësia e Allahut arrihet vetëm duke iu bërë hizmet të tjerëve për hir të Allahut Teala.”<sup>65</sup>*

Shejh Gavs-i Hizani thotë:

*“Asnjë sevap nuk mund të peshohet përballë sevapit të hizmetit.”<sup>66</sup>*

---

<sup>63</sup> Kushejri, Risale, f. 383.

<sup>64</sup> Mevlana Safim Reshehat, f. 175.

<sup>65</sup> Mevlana Safi, Reshehat f. 174. Abdulmexhid Hani, el-Hadaiku`l-Verdijje, f. 160.

<sup>66</sup> Sejjid Sibgatullah, Minah, f.20.

Ndërsa për hizmetin vetë Resulallahu s.a.v.s.,  
thotë:

**“Për mua, interesimi dhe puna për tejkalimin (plotësimin) e nevojës së vëllait mysliman është më e dashur se sa qëndrimi një muaj në itikaf në këtë xhami (Mesxhid-i Nebi).”** <sup>67</sup>

Transmetohet se Abdullah b. Abbasi r.a. kishte hyrë në itikaf në Mesxhid-i Nebi. Erdhi një njeri, e përshëndeti me selam dhe u ul pranë tij. Ibn Abbasi e shikoi në fytyrë njeriun dhe i tha:

*“O filan, nga fytyra juaj, ju shoh se jeni i mërzitur, keni ndonjë problem?”* Ai tha:

*“Po, o i biri i xhaxhait të Pejgamberit s.a.v.s.! I kam borxh filanit, më ndihmoi me para që sot ta arrij lirinë. Ndërsa tani nuk kam fuqi për t’ia kthyer borxhin.”* Ibn Abbas r.a., e pyeti:

*“A bën të flas unë me të për këtë çështje?”*

*“Fol, nëse do”,* i tha njeriu.

Ibn Abbasi veshi këpucët dhe doli nga xhamia, e njeriu e pyeti:

*“A harruat që jeni në itikaf?”*. Ibn Abbasi tha:

*“Jo, nuk harrova. Por e kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s... Nuk kaloj shumë kohë që u nda nga ne...”,* dhe i rrodhën lotët...

---

<sup>67</sup> Taberani, el-Mu`xhemu`l-Kebir, nr. 13646.

Më pas vazhdoi: “*Resulallahu s.a.v.s., tha*”:

**‘Kush interesohet dhe punon për tejkalimin e problemeve të vëllait mysliman, bën punë më të vlefshme se dhjetë vite itikaf. Ndërkaq, kush bën itikaf për Allahun, Allahu Teala hap tre hendeqe mes tij dhe zjarrit të Xhehenemit. Dhe, largësia e hendeqeve është sa largësia mes lindjes dhe perëndimit’.**<sup>68</sup>

*“Hizmeti është për ahiret. Hizmeti është veshja e ahiretit. Qefini nuk është kostum i ahiretit, qefini prishet.*

*Personi i cili del nga shtëpia për hizmet, deri sa të kthehet në shtëpi është në gjendje të dhikrit.”*

Shejh Sejjid Abdulbaki el-Husejni

---

<sup>68</sup> Taberani, el-Mu’xhemu’l`-Evsat, nr. 7322; Bejhaki, Shuabu`l-Iman, nr. 3960; Munziri, et-Terhib, 2/272.B.

